

FORMËSIMI I PAQES: PËRFSHIRJA E GRAVE NË PROCESIN E PAQES KOSOVË-SERBI

PRILL **2024**

Mbështetur nga



**Women's Peace &
Humanitarian Fund** 

A United Nations & Civil Society Partnership



Formësimi i Paqes: Përfshirja e Grave në Procesin e Paqes Kosovë-Serbi

Prill 2024

Formësimi i Paqes: Përfshirja e Grave në Procesin e Paqes Kosovë-Serbi

Ky studim politikash financohet nga:



Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analizat në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe Inclusive Peace, këto pikëpamje nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor i Zhvillimit dhe Çështjeve Evropiane (RIDEA) & Inclusive Peace

Prill 2024

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3
I. HYRJE	6
II. METODOLOGJIA	7
III. KORNIZA TEORIKE	8
1. Modeli I i proceseve të paqes dhe përfshirja e grave: Trende të përgjithshme	8
2. Përfshirja gjatë zbatimit	10
3. Proceset dhe faktorët mjedisor që mundësojnë dhe kufizojnë përfshirjen e grave	12
4. Korniza e diplomacisë shumë-planëshe	14
5. Përfshirja e grave në Modelin II të proceseve të paqes.....	16
IV. GJETJET KRYESORE	17
Hyrje	17
1. Vlerësimi i mësimave nga proceset e Modelit I dhe Modelit II	18
1.1. Vlerësim i përgjithshëm i kontekstit: momentet kritike dhe proceset e Modelit I	18
1.2. Zbatimi i marrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë	20
1.3. Iniciativat e Modelit II në Kosovë dhe roli i aktorëve të ndryshëm.....	22
2. Përfaqësimi dhe përfshirja e grave të Kosovës në proceset e paqes	25
2.1. Përfshirja e grave të Kosovës në proceset e Modelit I.....	25
2.2. Faktorët kufizues në përfshirjen e grave.....	26
2.3. Përfshirja e grave në Modelin II dhe Transferi nga Modeli II në proceset e Modelit I .	28
2.4. Përfshirja e grave në zbatim	30
3. Drejt proceseve gjithëpërfshirëse në Kosovë.....	30
3.1. Pikat hyrëse dhe rekomandimet strategjike për të rritur përfshirjen e grave në proceset Modelin II.....	30
3.2. Zbatimi dhe Monitorimi	33
3.3. Angazhimi i aktorëve ndërkombëtarë në mbështetjen e proceseve përfshirëse.....	34
V. PËRFUNDIMET	36
VI. SHTOJCAT	38

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në shkurt të vitit 2023, Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë (në vijim të referuara në tekst si: Kosova dhe Serbia për qëllime konsistence), me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, arritën një marrëveshje normalizimi, e ndjekur nga Ankesi i Zbatimit i nënshkruar më 18 mars. Ky zhvillim u kuptua si shprehje e angazhimeve të ndërsjella për gjetjen e zgjidhjeve për problemet afatgjate. Megjithatë, procesi i paqes ka hasur në pengesa të mëdha, veçanërisht në lidhje me zbatimin e marrëveshjes së normalizimit. Pavarësisht nga dëshmitë empirike për efektin pozitiv të përfshirjes më të madhe të grave në proceset politike, si në ndërmjetësim dhe ndërtim të paqes, dhe kërkesave normative për përfshirje më të madhe të grave në proceset politike, të përfshira nën agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria, e përqendruar në Rezolutën 1325 të OKB-së, mospërfshirja e grave nga procesi i paqes Kosovë-Serbi ende vazhdon.

Procesi i normalizimit në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk është i izoluar nga konteksti më i gjerë i proceseve bashkëkohore të paqes. Gjetjet dhe eksperiencat nga hulumtimet, politikat, dhe praktikat theksojnë gjithnjë e më shumë nevojën për të eksploruar hapësira dhe qasje alternative për paqebërje dhe ndërtim të paqes në mënyrë që të adresohen negociimet e ngecura dhe mungesat në zbatim. Ilustruar nga shembujt e proceseve formale të paqes që janë aktualisht në ngecje, kur orientohemi drejt proceseve shumështrësore, dalin në pah dy pyetje: Si të krijohen hapësira të reja dhe pika hyrëse për bërjen dhe ndërtimin e paqes në nivele të ndryshme, dhe si të tejkalohen pengesat në hapësira formale dhe joformale për të rritur përfshirjen e aktorëve historikisht të marginalizuar, siç janë gratë.

Në këtë aspekt, qasja shumëpalëshe, e cila dallon prej mjedisit formal të Modelit I dhe atij jo-formal të Modelit II, është thelbësore në kuptimin e përfshirjes në nivele të ndryshme. Korniza e raportit në vijim bazohet në literaturë dytësore dhe dëshmi krahasuese mbi ‘përfshirjen’ dhe një model ‘shumëpalësh’ për të analizuar burimet kryesore mbi proceset e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Analiza e intervistave synon të shërbejë dy qëllime kryesore: së pari, të bëjë një vlerësim të mësimave të nxjerra nga proceset e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë, dhe së dyti, të shqyrtohet çështja e përfshirjes së grave, duke ofruar njohuri mbi opsionet strategjike për të rritur rolin e grave në Modelin II dhe për të ndikuar në procesin formal të Modelit I.

Raporti përdor një studim cilësor të 43 intervistave të strukturuar që përfshijnë aktorë të përfshirë në politikë, shoqëri civile dhe diplomatë ndërkombëtarë të angazhuar direkt ose indirekt, në Modelin I dhe Modelin II të ndërtimit të paqes në Kosovë. Duke u mbështetur në koncepte nga teori ekzistuese dhe korniza normative të politikave ndërkombëtare, si dhe korniza analitike të zhvilluara nga Inclusive Peace, mbledhja e të dhënave mbi përfshirjen e grave në Modelin II trajtoi tri periudha të ndryshme në procesin e paqes Kosovë-Serbi: përvoja e kaluar e angazhimit të grave në proceset formale dhe joformale, konteksti i fazës së zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit, dhe mënyrat për të bërë proceset më gjithëpërfshirëse në të ardhmen. Kështu, rolet, kontributet dhe ndikimi i grave - dhe aktorëve të shoqërisë civile më gjerësisht - në fazat e negociatave dhe zbatimit ishin në qendër të hulumtimit.

Gjetjet Kryesore

Të dhënat nga intervistat nxorën në pah perspektiva të ndryshme mbi zgjidhjet e mundshme për të adresuar stagnimin aktual. Në të gjitha intervistat, ajo që del në pah në këtë spektër të gjerë të perspektivave është kuptimi i përbashkët se gratë janë përjashtuar dhe se ka nevojë për të rritur përfshirjen e tyre.

Së pari, proceset e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë shihen si një proces në gjendje stagnimi, me aktorët politikë të cilët i perceptojnë ato si një platformë për kompromise të panevojshme apo një lojë pa rezultat. Të tjerët shprehin shqetësime për angazhime të dobëta të brendshme dhe për reduktimin e ndikimit të jashtëm të BE-së, e cila ka udhëhequr përpjekjet për dialog në zhvillimin e procesit. Gjetjet mbështesin nocionin e natyrës gjerësisht ekskluzive të procesit, me shumë të intervistuar duke e cilësuar si proces elitist, të fokusuar nga lart-poshtë, dhe të imponuar nga aktorët ndërkombëtarë.

Së dyti, intervistat nxjerrin në pah sfidat e përfshirjes *kuptimplotë* të grave, veçanërisht në kuptimin e të qenit të pranishme por jo të përfaqësuar. Pavarësisht përparimeve në përfaqësimin e grave në pozicione udhëheqëse, ky progres ka dështuar të përkthehet në një përfshirje më të gjerë kuptimplotë dhe ka pësuar një mungesë angazhimi të mirëqenë ndaj një agjende të ndjeshme gjinore.

Së treti, sa i përket përfshirjes së grave në Modelin II, vetëm një numër i kufizuar i pjesëmarrësve që janë angazhuar direkt në iniciativa të mëparshme kanë mundur të identifikojnë shembuj

specifikë të kontributeve të grave në dialogun Kosovë-Serbi. Edhe në këta shembuj të paktë të anagzhimeve të kaluara, gratë kanë hasur në pengesa rreth njohjes së tyre. Faktorët kufizues më të shquar në lidhje me procesin dhe kontekstin për përfshirjen e grave në procese të paqes përfshijnë nënfaqësimit në vendimmarrje dhe negociatat formale dhe qëndrimet dhe pritjet shoqërore që lidhen me rolet gjinore në Kosovë.

Raporti identifikon pikat e mëposhtme hyrëse dhe opsionet për të ecur përpara dhe për të rritur përfshirjen e grave në procesin e paqes të Modelit II dhe transferit ndërmjet modeleve:

- Rishikimi dhe ndryshimi i qasjes dhe strategjive të përfshirjes në raport me aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë;
- Pronësia lokale dhe qasja ndërseksionale në zhvillimin e kritereve të përfshirjes;
- Nxitja e ndërtimit të besimit dhe pajtimit në nivelin e komunitetit (dhe zgjerimi i angazhimit lokal);
- Përmirësimi i transparencës dhe komunikimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovë;
- Zhvillimi i strategjive avokuese mes grave paqëndrues të Kosovës;
- Ngritja e mekanizmave konsultativ mes aktorëve të Modelit I dhe Modelit II;
- Ndryshimi i fushëveprimit të agjendës dhe adresimi i çështjeve të ndjeshme gjinore.

Të intervistuarit theksojnë se rritja e përfshirjes së grave shihet nga shumë njerëz si e nevojshme për zbatimin e qëndrueshëm dhe të suksesshëm të procesit të paqes. Rëndësia e përfshirjes së grave në avancimin e proceseve të ngecura u shfaq si një pikë fokale kritike për thyerjen e mundshme të stagnimit aktual. Megjithatë, përfshirja e grave në kontributin e tyre në proces dhe monitorimin e progresit është ende e mangët. Ndër të intervistuarit, ekziston një konsensus në rritje ndaj nevojës për t'i dhënë formë të re zbatimit me një qasje nga poshtë-lartë, me epiqendër qytetarët. Pjesëmarrësit e intervistuar për këtë studim, kërkojnë zgjidhje dhe mjete të reja për të përmirësuar monitorimin dhe zbatimin, theksojnë nevojën për monitorim të përbashkët gjithëpërfshirës, që përfshin shoqërinë civile, gratë paqëndrues, qeverinë dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë. Bashkëpunimi efektiv në modelet specifike ndaras, si dhe ndërmjet modeleve, do të përfitonte poashtu nga indikatorët konkretë dhe hapat që angazhojnë komunitetet lokale në Kosovë.

I. HYRJJE

Në shkurt 2023, duke u bazuar në procesin e mëparshëm të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, Kosova dhe Serbia arritën Marrëveshjen e Brukselit për normalizim, me mbështetje ndërkombëtare nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo marrëveshje historike u përforcua më tej nga Aneksi i Zbatimit i nënshkruar më 18 mars 2023 në Ohër. Megjithatë, pavarësisht arritjeve të fundit (të cilat definoohen si përparime diplomatike), me problemet që vazhdojnë të jenë në bërthamën e mosmarrëveshjes së gjatë, zbatimi i mëtejshëm i marrëveshjeve ka hasur në sfida të rëndësishme.

Ndërkohë që problemet vazhdojnë të ekzistojnë, është e qartë se ende ka zbrazëtira të mëdha në përfshirjen e grave në proceset formale të paqes (Modeli I) dhe në aktivitetet joformale të ndërtimit të paqes (Modeli II). Me këtë qëllim, ky studim synon të adresojë këto zbrazëtira kritike, duke u fokusuar në aktivitetet e Modelit II, duke pasur parasysh rëndësinë e potencialit të tyre për të riformuar angazhimin për të bërë proceset më gjithëpërfshirëse. Objektivi kryesor i këtij studimi është i dyfishtë: së pari, të shërbejë si një ndërmarrje për grumbullimin e të dhënave mbi rolin dhe potencialin e grave në faza të ndryshme të proceseve të paqes në mes të Serbisë dhe Kosovës, dhe së dyti, të ofrojë një kuptim të kontekstualizuar të faktorëve kufizues dhe lehtësues për përfshirjen e grave në proceset e paqes dhe opsione strategjike për aktorët e brendshëm dhe të jashtëm për të bërë proceset në vazhdim më gjithëpërfshirëse.

Ky studim është organizuar si vijon: Kapitulli I ofron hyrjen dhe përmbledhjen që vendos këtë studim politikash në kontekstin bashkëkohor; Kapitulli II përshkruan mbledhjen e të dhënave, dizajnin e hulumtimit dhe metodologjinë, dhe konceptet teorike të përdorura për analizën në vijim. Kapitulli III paraqet një rishikim të literaturës mbi proceset shumëpalëshe të paqes dhe përfshirjen e grave. Kjo pjesë më tej bazohet në gjetjet e mëparshme mbi përfshirjen në zbatimin e marrëveshjeve të paqes. Kapitulli IV ekzaminon në mënyrë cilësore intervistat dhe ofron gjetjet kryesore të studimit mbi përfshirjen e grave në proceset e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Seksioni final i studimit është i dedikuar për identifikimin e pikave kyçe hyrëse dhe rekomandimeve që të kihen parasysh nga zbatuesit e ndërtimit të paqes në përpjekjet e tyre për të bërë proceset e paqes të Modelit II më gjithëpërfshirëse.

II. METODOLOGJIA

Ky studim politikash bazohet në intervistat e zbatuara nga Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA), me qëllim të mbledhjes së informatave mbi proceset e kaluara të paqes dhe përfitimit të njohurive mbi përfshirjen e grave në aktivitetet e Modelit II në proceset e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Të dhënat janë mbledhur nga 43 intervista të strukturuar me aktorë politikë, aktorë ndërkombëtarë, aktorë kombëtarë dhe lokal të shoqërisë civile nga Kosova, duke përfshirë organizatat për të drejtat e grave, aktivistë, ekspertë dhe media (shumica e pjesëmarrësve ishin gra). Udhëzuesi i intervistës është hartuar mbi bazën e njohurive të Inclusive Peace mbi përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile në proceset e paqes dhe tranzicionit politik, duke përfshirë dy korniza specifike analitike,¹ dhe ka shërbyer si bazë e procesit të mbledhjes së të dhënave. Duke pasur parasysh fokusin e këtij raporti në pjesëmarrjen e grave në proceset e Modelit II, 'gjithëpërfshirja' në studim i referohet në mënyrë specifike pjesëmarrjes dhe ndikimit të aktorëve të ndryshme gra, përtej palëve kryesore të negociatave. Intervistat janë fokusuar në faza të ndryshme të proceseve të kaluara dhe atyre në vazhdim. Së pari, pjesëmarrësit me njohuri dhe përvojë profesionale reflektuan mbi proceset e kaluara të paqes dhe nismat e Modelit II, duke u fokusuar veçanërisht në rolin e grave në këto përpjekje. Kjo fazë fillestare ka synuar të identifikojë dhe analizojë angazhimet e kaluara duke përdorur konceptet kyçe të 'diplomacisë së Modelit II', 'përfshirjes' dhe 'transferit'. Duke u mbështetur në këto koncepte, intervista ka vazhduar në kontekstin aktual dhe ka eksploruar fazën e zbatimit, duke u fokusuar veçanërisht në rolet e grave dhe sfidat me të cilat përballen ato. Së fundi, intervistat kanë përfunduar duke mbledhur perspektivat e pjesëmarrësve mbi pikat e ardhshme hyrëse në ndërtimin e paqes dhe mënyrat për t'i bërë ato më gjithëpërfshirëse. Të dhënat e mbledhura janë kategorizuar në tematika specifike përmes softuerit për analizë cilësore të përmbajtjes. Pasi është koduar një mostër prej 43 intervistash të strukturuar, segmentet përkatëse janë ekzaminuar përbrenda kornizave konceptuale të hulumtimit për përfshirje kuptimplotë dhe rritje të pjesëmarrjes. Kjo ka mundësuar identifikimin dhe interpretimin e gjetjeve për të përmbushur objektivat e studimit. Përveç kësaj, për të fituar një pamje më kuptimplotë, studimi shqyrton jo vetëm tematikat, por edhe frekuencat e shfaqjes së tyre. Faza përfundimtare e analizës ka përfshirë mekanizma organizativ për kontrollim dhe rishikim, si dhe marrjen e komenteve nga palët e interesit.

¹ Korniza e "modaliteteve të përfshirjes"; dhe korniza e "funksioneve të ndërtimit të paqes nga shoqëria civile".

Analiza e mëposhtme ka parasysh kufizimet në kuptimin e rolit dhe përfshirjes së grave në proceset e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Duke qenë se ky është një studim cilësor i cili pasqyron paragjykimet e studiuesve në interpretimin e të dhënave, operacionalizimi i koncepteve dhe shtrirja e tyre në indikatorë të vëzhgueshëm është sfiduese, duke e bërë kështu subjektive natyrën e kodimit cilësor. Pavarësisht këtyre kufizimeve, duke shqyrtuar aspektet e kontekstit që janë neglizhuar paraprakisht, studimi ofron njohuri të vlefshme për studiuesit dhe politikëbërësit.

III. KORNIZA TEORIKE

1. Modeli I i proceseve të paqes dhe përfshirja e grave: Trende të përgjithshme

I bazuar në një numër teorish në fushën e studimeve politike dhe të paqes, termi *gjithëpërfshirje* ka evoluar në një koncept ombrellë që përmbledh një gamë të gjerë praktikash dhe politikash, si dhe pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e aktorëve të ndryshëm. Ndërsa koncepti i përfshirjes është zhvilluar dhe rritur në shumë mënyra, ky raport thellohet në mënyrë eksplicite në përfshirjen gjinore. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se përfshirja e grave ka shërbyer si një katalizator për inkurajimin e pjesëmarrjes së grupeve të tjera. Hulumtimet e dekadës së fundit kanë konceptuar se si aktorët civilë, përtej palëve kryesore në konflikt, mund të përfshihen në proceset e paqes dhe të tranzicionit politik,² dhe gjithashtu kanë demonstruar se përfshirja e grave në proceset formale të paqes ka gjeneruar ndryshme pozitive. Në veçanti, qasja dhe ndikimi i grave në negociatat formale të paqes rrit mundësinë e arritjes dhe zbatimit të marrëveshjeve të paqes.³ Marrëveshjet e paqes të nënshkruara nga gratë gjithashtu kanë më shumë gjasa të prodhojnë paqe afatgjatë sesa marrëveshjet e paqes që nuk nënshkruhen nga gratë.⁴ Së treti, pjesëmarrja

² Projekti i shumëvjeçarë "Gjerësimi i Pjesëmarrjes në Negociatat Politike dhe Zbatim", duke aplikuar analizën krahasuese të 40 studimeve të rasteve, bëri një ekzaminim të plotë të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit shoqëror në proceset formale të paqes dhe tranzicionit politik. Studimi sollti një tipologji të modaliteteve të përfshirjes, duke përfshirë përfaqësimin drejtpërdrejt në tryezën e negociatave, statusin e vëzhguesit, konsultimet, komisionet e përfshira, punëtorët e nivelit të lartë për zgjidhjen e problemeve (Modeli I.5), vendimmarrjen publike dhe veprimin masiv. Iniciativa për Paqen dhe Tranzicionin e Përfshirë, "Gjerësimi i Pjesëmarrjes në Negociatat Politike," (Gjenevë: 2011-2017), <https://www.inclusivepeace.org/project/broadening-participation/>

³ Iniciativa për Paqen dhe Tranzicionin e Përfshirë, "Gjerësimi i Pjesëmarrjes në Negociatat Politike," (Gjenevë: 2011-2017), <https://www.inclusivepeace.org/project/broadening-participation/>; Kreutz/Cárdenas 2024; O'Reilly et al. 2015; Paffenholz et al. 2016.

⁴ Laurel Stone, "Gratë që Transformojnë Konfliktin: Analiza Kuantitative e Paqes Femërore," Dokumenti Shkencor i SSRN (Rochester, NY, 13 Maj 2014), <https://doi.org/10.2139/ssrn.2485242>; Jana Krause, Werner Krause, dhe Piia Bränfors, "Pjesëmarrja e Grave në Negociatat për Paqen dhe Durueshmëria e Paqes," Ndërveprimet Ndërkombëtare 44, nr. 6 (2 nëntor 2018): 985–1016, <https://doi.org/10.1080/03050629.2018.1492386>.

kuptimplotë e grave në proceset e paqes në Modelin I ose Modelin II rritë probabilitetin e marrëveshjeve të paqes që përfshijnë provizione gjinore.⁵

Pavarësisht nga angazhimi normativ për përfshirjen e grave në proceset e paqes dhe të tranzicionit politik – kryesisht i bazuar në agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria (WPS) që përqendrohet në Rezolutën 1325 të OKB-së, si dhe rritjen e dëshmimeve të ndikimit pozitiv të pjesëmarrjes së grave, përjashtimi i grave nga proceset e paqes vazhdon të jetë ende i përhapur. Në veçanti, mesatarisht 13 për qind e të gjithë negociatorëve të përfshirë në proceset formale të paqes në mbarë botën kanë qenë gra përgjatë viteve 1992 dhe 2019. Proceset e paqes me gra ndërmjetësuese dhe nënshkruese të marrëveshjeve të paqes kanë qenë më shumë si një përjashtim gjatë asaj periudhe.⁶ Për më tepër, një numër faktorësh kanë kufizuar ndikimin e grave në proceset formale të paqes ku kanë qenë të përfshira (shih më poshtë).

Në të njëjtën kohë, proceset formale të paqes janë gjithnjë e më shumë në ngecje ose të bllokuara. Aktualisht, ka vetëm katër procese të paqes të udhëhequra nga OKB-ja, të cilat kanë pasur pengesa në përparim ndër vite. Prandaj, studiuesit vënë në dyshim gjithnjë e më shumë mbizotërimin e tavolinës tradicionale të negociatave për paqebërje dhe ndërtim të paqes.⁷ Eksplorimi i hapësirave alternative dhe qasjeve ndaj paqebërjes dhe ndërtimit të paqes⁸, si dhe gjetja e kuptimit të përbashkët për gjithëpërfshirje janë dy pika hyrëse në këtë drejtim. Gjithëpërfshirja, për shembull, mund të kuptohet më mirë si çështje që ka të bëjë me trajtimin e çështjeve gjinore gjatë negociatave dhe jo si prani e fizike e grave në tryezën e bisedimeve.⁹ Vëmendja ndaj hapësirave dhe dinamikave të ndryshme në proceset formale dhe joformale të paqes mund të ndihmojë si për të kuptuar ashtu edhe për të adresuar pengesat për përfshirjen e grave dhe për të promovuar iniciativa me ndikim në paqebërje dhe ndërtim të paqes (shih seksionin mbi "kornizën e diplomacisë shumëplanëshe" më poshtë).

Këta faktorë - mungesa e ndikimit në paqebërjen formale, së bashku me rritjen e joefektivitetit dhe stagnimit të procesit formal të paqebërjes - ngrisin pyetje themelore në lidhje me drejtimin dhe dobinë e qasjeve tradicionale të përfshirjes. Ky studim politikash synon të reflektojë dhe t'i marrë

⁵ True dhe Riveros-Morales 2019.

⁶ Këshilli për Marrëdhëniet Nderkombëtare 2020.

⁷ Pospisil 2019, fq. 21; Meininghaus 2021.

⁸ Paffenholz 2021; Porter/Riley 2021; De Coning et al. 2023; Aboueldahab 2022.

⁹ Hirblinger/Landau 2020.

në pyetje këto çështje në kontekstin e përpjekjeve paqebërëse në Kosovë (dhe Serbi) dhe kërkon të zbulojë qasje alternative duke pasur parasysh këta faktorë dhe dinamikat mbizotëruese.

2. Përfshirja gjatë zbatimit

Përfshirja në fazën e zbatimit është një nga temat kryesore të eksploruara në këtë raport. Zbatimi i suksesshëm i marrëveshjeve të paqes është i domosdoshëm për arritjen e paqes cilësore e cila përfshin shtetndërtimin dhe transformimet e qëndrueshme sociale, ekonomike dhe politike.¹⁰ Megjithatë, pavarësisht dëshmive të qarta nga studimet cilësore dhe sasore për rolin vendimtar që luan zbatimi i marrëveshjeve, një pjesë e rëndësishme e analizave në ndërtimin e paqes ka një fokus disproporcional në fazat formale të negociatave.

Marrëveshjet e paqes shpesh kritikohen se janë marrëveshje afat-shkurta elitare për ndarjen e pushtetit, që përkeqësojnë ndarjen dhe përjashtojnë grupet e marginalizuara, përfshirë gratë,¹¹ si dhe nuk adresojnë shkaqet themelore të konfliktit.¹² Fokusi në shpërndarjen e pushtetit gjatë negociatave luan rol në zbatimin e provizioneve. Hulumentimet krahasuese sugjerojnë se zbatimi shpesh përfshin një rinegocim të vazhdueshëm të marrëveshjeve i cili ndodh përbrenda mjediseve formale dhe, shpeshherë, joformale të negociatave.¹³ Marrëveshjet e paqes gjithashtu shihen si udhërrëfyes që kanë nevojë për një qasje fleksibile ndaj zbatimit dhe jo një kornizë strikte për zbatimin e ndryshimeve.¹⁴ Një numër i madh i dëshimeve, që është vazhdimisht në rritje, sugjeron se modeli tradicional i ndërtimit të paqes sipas të cilit proceset e paqes përparojnë në mënyrë lineare nga armëpushimi dhe para-negotiatat në negociata dhe në zbatimin e një zgjidhjeje politike nuk qëndron.¹⁵ Në fakt, faza e zbatimit në kontekste të ndryshme (përfshirë marrëveshjet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë) shpesh ndodh njëkohësisht me negociatat dhe përfshin ndryshime të gjata në proceset politike dhe në qeverisje.

¹⁰ Terrence Lyons, "Zbatimi i Paqes dhe Paqja e Cilësisë," në *Përkuptimi i Paqes së Cilësisë: Ndërtimi i Paqes pas Luftës Civile*, red. Madhav Joshi dhe Peter Wallensteen (Londër dhe Nju Jork: Routledge, 2018), 29–44.

¹¹ Shih për shembull, Deiana 2016; Kennedy et al. 2016; Wise 2018.

¹² MacGinty 2010; Porter/Riley 2021.

¹³ Thania Paffenholz dhe Alexander Bramble, "Zbatimi i Marrëveshjeve për Paqe: Nga Proceset Inkluzive te Rezultatet Inkluzive?," Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Jeta e Pajisur. Kombet e Forta (Iniciativa për Paqen dhe Tranzicionin e Përfshirë, 2020).

¹⁴ Terrence Lyons, "Zbatimi i Suksesshëm i Paqes: Planet dhe Proceset," *Ndërtimi i Paqes* 4, nr. 1 (2016): 71–82, doi:10.1080/21647259.2015.1094906.

¹⁵ Paffenholz 2021. Shih gjithashtu Pospisil dhe Bell 2017 dhe De Coning 2018 në devijime nga modeli i ndërtimit të paqes liberal.

Kjo perspektivë alternative gjithashtu zhvendos njësinë analitike të fokusit nga negociatat dhe marrëveshjet në *proces*, ku hyn një gamë e gjerë aktorësh që luajnë rol të rëndësishëm në formësimin e strukturës së pushtetit shoqëror. Edhe pse roli i gjithëpërfshirjes në procesin e zbatimit nuk ka marrë vëmendje të mjaftueshme nga studiuesit dhe praktikuesit, dëshmitë e fundit nga kërkimet krahasuese mbështesin pikëpamjen se zbatimi gjithëpërfshirës mund të ndihmojë në vazhdimin e një procesi paqeje ose tranzicioni politik.¹⁶

Përtej negociatave, zbatimi shpesh bëhet një proces kompleks i cili zhvillohet në një sërë mjedisesh formale dhe joformale, duke krijuar një proces me shumë shtresa.¹⁷ Si i tillë, ndërkohë që modalitetet e lartëpërmendura të përfshirjes mbeten shumë të rëndësishme, procesi i zbatimit - veçanërisht pasi që përfshin nivele të ndryshme në rinegocimin e kushteve - mund të zgjerojë gjithashtu fushën e përfshirjes përtej tryezës fillestare të negociatave.

Së fundi, ndërsa gratë mbajnë peshën kryesore të vështirësive ekonomike, sociale dhe mjekësore që shkakton konflikti i armatosur,¹⁸ ato mund të përdorin periudha të përshkallëzimit të dhunës për të zënë pozicione me ndikim ekonomik dhe shoqëror në shoqëri që mbahen nga burrat.¹⁹ Megjithatë, gjatë fazës së zbatimit, gratë shpesh duhet të përballen me përpjekjet e burrave për të rivendosur rendin patriarkal para-ekzistues. Kjo "përsëritje patriarkale" nxitet nga një kombinim i normave patriarkale, sjelljeve të militarizuara, abuzimit me drogën dhe alkoolin, si dhe qasjes së lehtësuar në armë.²⁰ Burrat që përdorin dhunë kundër grave që janë përkrahëse të paqes dhe të drejtave të grave,²¹ kundër grave në përgjithësi,²² dhe që minojnë zbatimin e kuotave gjinore²³, janë shembuj të manifestimeve të reagimit patriarkal. Një pikë hyrëse potenciale drejt zbutjes së reagimeve patriarkale është përdorimi i kuotave gjinore me masa të tjera të veçanta të përkohshme që mundësojnë *transformimin* e normave dhe vlerave patriarkale të rrënjosura thellë. Këto masa mund të marrin formën e një trajnimi efektiv për gratë delegate në termat e negociatave dhe zbatimit të paqes ose në fushata avokuese që rrisin mbështetjen publike për provizione gjinore,

¹⁶ (Paffenholz dhe Bramble 2020).

¹⁷ Ibid.

¹⁸ Shih për shembull, Cohen dhe Nordas 2014; Bendavid et al. 2021; Brounéus et al. 2024; McKay 1998; Le/Nguyen 2020; Danjibo/Akinkuotu 2019.

¹⁹ Webster et al. 2019 ; Tripp 2023; Bakken/Buhaug 2021.

²⁰ Berry 2017; Berry et al. 2020; Close 2018, fq. 11.

²¹ Zulver 2021.

²² Matfess et al. 2022.

²³ Close 2018; Niner et al. 2021.

ndër të tjera.²⁴ Ndërsa gratë përballen me kufizime, një agjendë e ndjeshme gjinore, e cila ka parasysh pabarazitë dhe merr parasysh ndikimin e gjinisë në një çështje të caktuar, mund të krijojë një mundësi për ushtrim të agjencisë për identitetet gjinore të marginalizuara.

3. Proceset dhe faktorët mjedisor që mundësojnë dhe kufizojnë përfshirjen e grave

Ka një numër faktorësh që mund të mundësojnë ose kufizojnë ndikimin e grave në proceset e paqes dhe tranzicionit. Ato mund të grupohen në dy kategori: grupi i parë i "faktorëve të procesit" lidhet me mënyrën se si është projektuar procesi i përfshirjes; grupi i dytë i "faktorëve të kontekstit" lidhet me kontekstin në të cilin ndodh kjo përfshirje.

Nëntë faktorë të procesit që mundësojnë ose kufizojnë mundësinë e grave për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në proceset e paqes janë:²⁵

1. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes;
2. Procedurat e vendimmarrjes;
3. Koalicionet dhe qëndrimet e përbashkëta;
4. Strategjitë e transferit, komunikimit dhe avokimit;
5. Qëndrimi i palëve në konflikt dhe i ndërmjetësuesve;
6. Përfshirja e hershme e grave në proces;
7. Struktura mbështetëse për gratë;
8. Monitorimi i provizioneve gjinore dhe të grave;
9. Financimi.

Nëntë faktorë të kontekstit që ndikojnë në përfshirjen e grave janë:²⁶

1. Rezistenca ose mbështetja e elitës;
2. Blerja/Mbështetja publike;
3. Ndikimi i aktorëve rajonalë dhe ndërkombëtarë;
4. Prania e grupeve, rrjeteve apo lëvizjeve të forta të grave;
5. Heterogjeniteti i identiteteve të grave;
6. Qëndrimet dhe pritshmëritë shoqërore rreth roleve gjinore;

²⁴ Poppelreuter et al. 2022; see also Ross 2022.

²⁵ Ibid. (= > Paffenholz et al. 2016), fq. 8-9.

²⁶ Ibid., fq. 50-54.

7. Rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të grave;
8. Ekzistenca e zotimeve të mëparshme apo provizionet gjinore;
9. Gatishmëria e grave.

Këto procese dhe faktorë kontekstual lidhen me modalitete të ndryshme të gjithëpërfshirjes dhe ndodhin në faza të ndryshme të proceseve të paqes dhe tranzicionit politik. Disa faktorë, veçanërisht kriteret dhe procedurat për përzgjedhje dhe vendimmarrje, mund të ndihmojnë në rritjen e numrit të grave që marrin pjesë ose përfaqësohen në një proces paqeje. Megjithatë, hulumtimet poashtu sugjerojnë se rritja në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave nuk përkthehet automatikisht në ndikim.²⁷ Së pari, palët e konfliktit ose palët e treta që mbështesin procesin mund ta shohin përfshirjen e grave si vetëm përfaqësim simbolik. Edhe kur i kushtojnë vlerë çështjes, nuk arrijnë të integrojnë perspektivat gjinore në proceset e paqes. Së dyti, mungesa e unitetit dhe e vetëorganizimit mes grave mund të pengojë ndikimin e tyre kolektiv, siç tregohet nga rastet e dialogut kombëtar në Nepal (2008-2012) dhe Jemen (2013)²⁸. Së treti, burrat janë mbështetur në stereotipet patriarkale për t'i përshkruar gratë delegate të negociatave si të papërshtatshme për të marrë pjesë në negociatat e paqes dhe në politikë. Përrjashtimi i grave delegate në negociatat e paqes nga hapësirat joformale të vendimmarrjes ka minuar më tej ndikimin e tyre mbi negociatat.²⁹ Së fundi, normat dhe pritshmëritë shoqërore mund të dobësojnë pranimin nga publikut dhe gratë mund të përballen me kufizime për shkak të presioneve shoqërore dhe mungesës së kapaciteteve.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se një fokus i tepërt në proceset formale të paqes shpesh pengon përfshirjen e grave, duke anashkaluar hapësirat dhe strategjitë që gratë përdorin për të ndikuar në mënyra më pak të dukshme dhe më pak formale. Sipas Paffenholz, aktorët e shoqërisë civile shpesh mënjanojnë nga negociatat e paqes për shkak të shqetësimeve se përfshirja e tyre mund të komplikojë bisedimet, të çojë në sfida dhe të kundërshtohet nga palët e rëndësishme të konfliktit.³⁰ Radikalizimi i shoqërive dhe një numër relativisht i kufizuar i nismave dhe pjesëmarrësve mund të pengojnë efektivitetin e nismave të Modelit II.³¹ Kjo është veçanërisht

²⁷ Shih gjithashtu Ellerby 2016; Nakaya 2003.

²⁸ Bramble/Paffenholz 2020, fq. 41; Porter dhe Riley 2021, fq. 15.

²⁹ Paffenholz et al. 2016, pp. 24 and 39-40; Kostovicova and Paskhalis 2021.

³⁰ Shih gjithashtu Mendes 2019, fq. 276.

³¹ Thania Paffenholz, "Përshtypje të Përgjithshme të Rezultateve për një Projekt Kërkimor Krahasues: Shoqëria Civile dhe Ndërtimi i Paqes," qasur më 13 Shkurt 2024.

e rëndësishme për këtë raport i cili identifikon tendencat e radikalizimit, politizimin e mjedisit dhe tensionet në procesin e normalizimit. Këto paraqesin pengesa të rëndësishme për përfshirjen kuptimplotë të aktorëve të Modelit II nëse shkalla dhe natyra e ndërhyrjeve nuk përputhen me sfidat.

4. Korniza e diplomacisë shumë-planëshe

Korniza e diplomacisë shumëpalëshe ofron një model për të shqyrtuar përfshirjen kuptimplotë të grave në proceset e paqes, përfshirë atë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo kornizë pranon dhe përvijon udhët dhe pikat e veçanta, si dhe lidhjet e tyre në ndërtimin e paqes dhe paqebërje, dhe vazhdon të ketë një rol të madh në informimin e praktikës në terren. Negociatat formale dhe bisedimet e nivelit të lartë ndërmjet palëve të konfliktit zakonisht vendosen në Modelin I. Njëkohësisht, iniciativat e Modelit II përfaqësojnë seminare, sesione dialogu dhe aktivitete për zgjidhjen e problemeve, të dizajnuara në mënyrë strategjike për të rindërtuar besimin dhe marrëdhëniet midis palëve të ndryshme të interesit. Qëllimi i tyre kryesor është kuptuar si mbështetja dhe ndikimi i drejtpërdrejtë dhe indirekt në të ashtuquajturat negociata të Modelit I.³² Angazhimi “poshtë-lartë” në proceset e paqes që përfshijnë iniciativa të komunitetit quhen iniciativa të Modelit III. Iniciativat nga ky model janë të dizajnuara për të krijuar lidhje horizontale dhe vertikale, si dhe qasje të reja që shpesh theksojnë nevojën për lidhje efektive mes niveleve të shumta, nga komuniteti e deri tek negociatat formale. Teoritë dhe praktikat më të fundit nxjerrin në pah një dallim në mes të gjeneratës së parë dhe të dytë të Modelit II. Termi “Modeli I.5” përfshin konceptin origjinal të Modelit II dhe aktivitetet më të gjera dhe të dallueshme të ndërtimit të paqes në mjedise formale dhe joformale.³³ Në përgjithësi, modeli me shumë nivele, duke lejuar përfshirjen e një spektri më të gjerë të shoqërisë, është shfaqur si një model i preferuar për ndërtimin e paqes duke e bërë atë një proces legjitim dhe më efektiv.

³² Thania Paffenholz dhe Kaitlyn Hashem, “Transferimi nga Ndërtimi i Paqes Nga Gjurma e Dy-të në Ndërtimin e Paqes Nga Gjurma e Parë: Një Fokus në Jemen dhe Siri” (Gjenevë: Paqja Përfshirëse, Nëntor 2022); shih gjithashtu Burgess/Burgess 2010.

³³ Thania Paffenholz, “Shoqëria Civile dhe Ndërtimi i Paqes: Një Vlerësim Kritik,” në Shoqëria Civile dhe Ndërtimi i Paqes (Botuesit Lynne Rienner, 2010), <https://doi.org/10.1515/9781685856878> .



Infografikë 1. Definimi i Modeleve: bazuar në raportin e Paffenholz dhe Hashem (2022)³⁴

Në lidhje me konceptualizimin e *transferit*, debatet e fundit diskutojnë nëse Modeli II i plotëson ose formëson mjediset formale. Në kontekstin e procesit të Modelit II, idetë dhe veprimet mund të lëvizin *lartë* për të ndikuar në negociatat e Modelit I ose *poshtë* për të ndikuar në opinionin publik. Prandaj, kuptimi i transferit ka shkuar përtej aktiviteteve të Modelit II që thjesht i mbështesin ose influencojnë proceset e Modelit I. Ekziston gjithashtu një dallim mes *strategjive të brendshme* (p.sh. konsultimet me vendimmarrësit) dhe të *strategjive të jashtme* (p.sh. përfshirja e mediave).³⁵

Dallohen pesë vëzhgime shtesë në lidhje me transferin. Së pari, transferi mbetet një koncept i paqartë të cilin aktorët dhe studiuesit e ndërtimit të paqes kanë vështirësi ta definojnë. Prandaj, njohuritë praktike mbi strategjitë efektive të transferit mbeten të pakta.³⁶ Së dyti, proceset e ngecura të Modelit I i komplikojnë tutje përpjekjet e grave dhe të shoqërisë civile për të ndikuar

³⁴ (Paffenholz dhe Hashem 2022).

³⁵ Esra Cuhadar dhe Thania Paffenholz, "Transferimi 2.0: Zbatimi i Konceptit të Transferimit nga Punët Në Gjurmë Dy në Negociatat Për Paqen Përfshirëse," Revista Ndërkombëtare e Studimeve 22, nr. 3 (1 Shtator 2020): 651–70, <https://doi.org/10.1093/istr/viz031> ; shih gjithashtu Palmiano Federer et al. 2019 për zgjerimin e kuptimit të proceseve Gjurmës II.

³⁶ Paffenholz dhe Hashem 2022; shih gjithashtu Palmiano Federer et al. 2019.

në Modelin I.³⁷ Përpjekjet “joformale” të grave për dialog, siç janë diplomacia lëvizëse (shuttle) kanalet e lehtësimit në prapaskenë ose masat për ndërtimin e besimit, janë identifikuar si një pikë hyrëse drejt ringjalljes së proceseve të ngecura të paqes.³⁸ Këto përpjekje mund të rrisin gjithashtu ndikimin e grave në proceset formale të paqes. Së treti, përfaqësueset gra në proceset e Modelit I janë shpesh të shkëputura nga gratë “lokale”, të cilat punojnë në zona të brishta të ndikuara nga konflikti. Një kuptim më i mirë i dinamikës, tensioneve dhe pengesave që lidhen me shkëmbimin e grave në negociatat formale të paqes me homologët e tyre vendas do të ndihmonte në hartimin e strategjive më të fuqishme të transferit që nxisin procese gjithëpërfshirëse të Modelit I.³⁹ Së katërti, diplomacia lëvizëse e Modelit II mund të jetë më efektive në adresimin e nxitësve kontekstual strukturorë të konfliktit sesa proceset formale të paqes, shpesh të ndërmjetësuara nga aktorët perëndimorë të cilët mund t'i japin përparësi zgjidhjeve afatshkurtra për t'i dhënë fund konfliktit të armatosur.⁴⁰ Trajtimi i proceseve të Modelit II dhe Modelit I si të barabarta dhe largimi nga koncepti i transferit mund të nxisë paqebërjen gjithëpërfshirëse dhe ndërtimin e paqes, si dhe mund të shkëputë varësitë dhe kontingjentet e rrugëve që shpesh lidhin "suksesin ose dështimin" e proceseve të Modelit II me përpjekjet e Modelit I.⁴¹ Së pesti, trendi për zgjerimin e konceptualizimeve të diplomacisë së Modelit II, të përmendur më sipër, ka qenë i favorshëm për përfshirjen e shoqërisë civile në aktivitetet e Modelit II.⁴²

5. Përfshirja e grave në Modelin II të proceseve të paqes

Praktika e ndërtimit të paqes shpeshherë ka neglizhuar diversitetin brenda shoqërisë civile. Theksi është vënë shpesh në grupet e shoqërisë civile të orientuara nga elita, të cilat vetëm pjesërisht pasqyrojnë pikturën më të gjerë shoqërore, veçanërisht në shoqëritë joperëndimore ku pjesëmarrja politike merr forma të ndryshme nga ato që përfshihen në teorinë dhe praktikën perëndimore dhe liberale të ndërtimit të paqes. Edhe pse analizat e fundit të proceseve të paqes ende vazhdojnë të përqendrohen rreth aktiviteteve midis elitave politike dhe ushtarake, ka një njohje në rritje mbi kontributin e mundshëm që shoqëria civile mund të japë në proceset e paqes (shih më poshtë)⁴³.

³⁷ Ibid.

³⁸ Bell/Forster 2019.

³⁹ Meininghaus 2021.

⁴⁰ Aboueldahab 2022.

⁴¹ Paffenholz dhe Hashem 2022.

⁴² Palmiano Federer 2021.

⁴³ Shih për shembull, Nilsson/Svensson 2023.

Qasjet e reja mund të nxjerrin në pah edhe çështjet e marginalizimit, sfidat e koordinimit dhe fragmentimin brenda kontekstit më të gjerë.

Ndryshe nga praktikat e marginalizimit në proceset e Modelit I të përshkruara më sipër, gratë kanë një histori të gjerë të angazhimit aktiv në diplomacinë e Modelit II për të promovuar një zgjidhje të negociuar të konflikteve të armatosura. Dëshmitë krahasuese tregojnë se 60 për qind e proceseve formale të paqes ndërmjet viteve 1989 dhe 2017 janë shoqëruar me procese joformale të paqes. Ka dëshmi të qarta për përfshirjen e grupeve të grave në 71% të të gjitha atyre proceseve joformale të paqes.⁴⁴ Në veçanti, diplomacia e e Modelit II ku janë përfshirë gratë ka synuar të rrisë legjitimitetin e proceseve formale të paqes, ka mbrojtur përfshirjen e grave në bisedimet formale të paqes, ka monitoruar shkeljet e të drejtave të njeriut, ka ndërmjetësuar konfliktet lokale dhe ka nxitur përfshirjen e të drejtave të grave në marrëveshjet formale të paqes, mes tjerash.⁴⁵ Dialogu ndërmjet grave në vendet me konflikt ka ndihmuar gjithashtu në zbutjen e polarizimit dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për bisedime gjithëpërfshirëse të paqes.⁴⁶

IV. GJETJET KRYESORE

Hyrje

Struktura e këtij raporti synon të prezantojë gjetjet kryesore të studimit në tre seksione që ndjekin renditjen tematike në përputhje me kornizën e gjitëpërfshirjes në proceset shumë-palëshe. Kjo mundëson një eksplorim të nuancuar të roleve dhe përfshirjes së grave në çdo fazë përmes modeleve të ndryshme. Seksioni i parë përmban një përmbledhje të gjetjeve kryesore mbi kontekstin aktual dhe perspektivave ekzistuese mbi proceset e kaluara të Modelit I dhe Modelit II, dhe rolit të aktorëve të ndryshëm. Seksioni i dytë eksploron temën e cila ka një vëmendje të veçantë në raport: përfshirja e grave në modelet e ndryshme të proceseve të paqes dhe kufizimeve, dhe faktorët kontekstual që potencialisht kufizojnë ndikimin e grave në negociata dhe zbatim. Seksioni i fundit merr në konsideratë pikat hyrëse dhe perspektivat e ardhshme për veprime për gratë praktikuese në ndërtim të paqes dhe palët tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare, të interesit.

⁴⁴ Christien 2020.

⁴⁵ Dayal/Christien 2020.

⁴⁶ Villedas Arino 2010, fq. 26-27.

1. Vlerësimi i mësimave nga proceset e Modelit I dhe Modelit II

1.1. Vlerësimi i përgjithshëm i kontekstit: momentet kritike dhe proceset e Modelit

Për shumicën e pjesëmarrësve të intervistuar, momenti kritik në proceset e paqes ishte fillimi i dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet qeverive të Serbisë dhe Kosovës. Për disa, momentet më kritike datojnë nga Marrëveshja e Rambujesë (1999) dhe Bisedimet e Vjenës (2004-2007) deri në procesin më të fundit në vitin 2023, Marrëveshja e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve (me aneksin e Ohrit). Shumica e përgjigjeve nga intervistat gjithashtu i kushtojnë rëndësi të madhe negociatave për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, të cilat perceptohen si një pengesë kontroversiale për të gjitha palët e angazhuara përgjatë procesit të negociatave dhe zbatimit (për elaborim të momenteve kritike, shih Shtojcën C).

Shumë nga sfidat e dukshme në ndërtimin e paqes në Kosovë dhe Serbi janë të ngjashme me modelet e vëzhguara në kontekste të tjera. Kjo konfirmon se në kohët e fundit proceset formale të paqes kanë hasur në pengesa dhe stagnim në qasjen e tyre. Pengesat kryesore të identifikuara në këtë kontekst përfshijnë përjashtimin, mungesën e transparencës, ndarjen etnike, radikalizimin në rritje dhe instrumentalizimin e marrëveshjeve dhe iniciativave të kaluara.

Përjashtimi dhe mungesa e pronësisë në proceset formale të paqes

Proceset e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë karakterizuar gjerësisht si ekskluzive, pa pronësi lokale të mirëfilltë. Shumë nga përpjekjet e mëparshme, të para si procese të njëanshme nga lart-poshtë, janë kritikuar si elitiste dhe të imponuara nga aktorët ndërkombëtarë dhe politikë. Pavarësisht rezultateve pozitive, këto vlerësime i referohen gjerësisht dialogut të lehtësuar nga BE-ja - “dialogu është ndërtuar pa vullnet politik dhe përkrahje publike” (Intervista 39). Megjithatë, ndërsa ekziston një konsensus i gjerë për t'i bërë proceset më gjithëpërfshirëse dhe avokim për një qasje më të hapur dhe më përfshirëse, mendimet e të intervistuarve dallojnë efektshmërinë e mënyrave për të arritur zgjidhje të qëndrueshme. Disa besojnë se progresi i vërtetë mund të sigurohet vetëm nëpërmjet negociatave të drejtpërdrejta politike në nivelet më të larta. Në disa raste, kjo po ashtu shihet pozitivisht si një mënyrë për vazhdim të marrjes së mbështetjes ndërkombëtare në përpjekjet për ndërtimin e paqes.

Divergjencia e perspektivave lidhur me proceset që po zhvillohen nënvizon se si negociatat dhe zbatimi kanë evoluar në një dinamikë shumështrësore, me interpretime të ndryshme të kapacitetit të tyre për ndryshim. Lidhur me zhvillimet e fundit dhe marrëveshjet e vitit 2023, janë shfaqur perspektiva të ndryshme. Në një anë, këto zhvillime janë perceptuar të kenë përkeqësuar krizën për shkak të paqartësisë së tyre mbi qeverisjen në Kosovë dhe fuqizimit të elementeve jodemokratike në politikë (Intervista 17), (Intervista 1). Në anën tjetër, ato janë konsideruar si “më holistike” dhe më me potencial për të qenë “ndryshuese të lojës”, duke ofruar një hapësirë më të gjerë zbatimi (Intervista 26), (Intervista 20), (Intervista 17).

Sfidat e përfshirjes së grave në mjediset formale të Modelit I

Ekziston një konsensus mes shumicës së pjesëmarrësve se përfaqësimi i grave në procesin e dialogut ka munguar që në fillim. Pavarësisht mekanizmave të caktuar ligjor që janë në fuqi, Rezoluta 1325 e OKB-së që avancoi agjendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë ende nuk ka arritur të marrë përkushtim, njohje dhe zbatim (Intervista 43), (Intervista 12), (Intervista 6)⁴⁷. Modeli I vazhdon të jetë një proces i orientuar drejt burrave ku, përveç Kryenegociatores së mëparshme, znj. Edita Tahiri, gratë kanë munguar në pozita vendimmarrëse.

Mungesa e perspektivës gjinore në procesin e dialogut reflektohet në temat e ngritura në dialog të cilat fokusohen në sigurinë tradicionale dhe jo sigurinë njerëzore. Kjo reflektohet nga fakti se çështjet që prekin drejtpërdrejt gratë, si dhuna seksuale gjatë luftës, nuk janë sjellë në diskutime. Theksi i kushtohet rëndësisë që të mos ketë gra vetëm si përfaqësuese, por që të sigurohet një qasje e ndjeshme gjinore ndaj marrëveshjeve të paqes. Mungesa e një qasjeje të tillë konsiderohet si një pengesë e rëndësishme në procesin aktual të ndërmjetësimit (shih më poshtë për më shumë mbi përfshirjen e grave).

Mungesa e transparencës në proceset e Modelit I

Kufizimi i qasjes në informata ka sjellë pengesa të konsiderueshme në aftësinë e shoqërisë civile për të monitoruar procesin dhe për të mbajtur të informuar publikun dhe komunitetet që preken drejtpërdrejt nga marrëveshjet e arritura. Përveç kësaj, disa nga të intervistuarit kanë vërejtur

⁴⁷ Megjithatë, duket të ketë përpjekje të rinovuara për të fuqizuar angazhimet drejt avancimit të agjendës WPS dhe zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

probleme me dokumentimin dhe raportimin e proceseve, si dhe mungesën e koordinimit mes aktorëve të Modelit I - "së pari, duhet të ketë një dialog mes palëve të dialogut" (Intervista 9).

Marrëdhëniet etnike dhe kohezioni social

Draft Statuti për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë shihet si një nga pjesët më kundërthënëse të procesit të paqes. Disa pjesëmarrës shprehën shqetësime se statuti vendos një nivel të ri të qeverisjes në Kosovë (të cilësuar si jokushtetues), që mund të çojë në shpërbërje të shtetit të Kosovës (Intervista 8), (Intervista 1), (Intervista 14), (Intervista 24), (Intervista 35), (Intervista 27). Sipas disa pjesëmarrësve, kjo çështje konsiderohet si një pikë kritike e cila ka shuar dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, veçanërisht për shkak të mungesës së qartësisë dhe konsensusit nga palët e përfshira në dialog. Mungesa e transparencës, krahas paqartësisë së gjuhës së marrëveshjeve të arritura, shihet si problem i madh i cili ka lënë hapësirë për interpretime të ndryshme lidhur me zbatimin. Mungesa e konsensusit për statusin ligjor të marrëveshjeve të arritura pa nënshkrime nga përfaqësuesit e të dy vendeve po ashtu kanë marrë shumë kritika sepse liderët e të dy vendeve, krahas përfaqësuesve të BE-së, paraqesin narrativa të ndryshme për publikun.

1.2. Zbatimi i marrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë

Shumica e përgjigjeve konfirmojnë se progresi i dialogut ka ngecur për një kohë të gjatë dhe se zbatimi i marrëveshjeve ka ngecur prapa. Pa ndonjë qartësi në mënyrën si të adresohen çështjet dhe problemet, i gjithë procesi, dhe veçanërisht angazhimet e qeverisë, vazhdojnë të mbesin të paqarta. Ky studim ka identifikuar disa arsye mbi ngecjen e përgjithshme në arritjen e suksesit në proceset e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ambiguiteti dhe mungesa e transparencës në zbatim

Mungesa e transparencës në zbatim, duke përfshirë programet dhe reformat kombëtare në kuadër të procesit të integritimit Evropian, pengon llogaridhënien. Hezitimi i qeverisë për të biseduar me shoqërinë civile e ndërlikon tutje këtë çështje dhe e pengon pjesëmarrjen e qytetarëve dhe nismave lokale. Për më tepër, mungesa e transparencës nga qeveritë e Serbisë dhe Kosovës është ngritur si një faktor kyç i mungesës së besimit të publikut në këtë proces dhe në rritjen e tensioneve ndër-etnike pasi që nuk kuptohet se çfarë marrëveshjesh janë arritur. Ka shqetësime se nuk ka një interes

të vërtetë mes politikanëve lokalë, me përpjekjet e kaluara për dialog të brendshëm të nxitura kryesisht nga komuniteti ndërkombëtar (Intervista 5). Rasti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Sërbe përmendet si shembull i cili thellon mosbesimin për shkak të mungesës së transparencës nga qeveria. Si rezultat, transparenca shihet si faktor thelbësor në punën e shoqërisë civile për të informuar publikun e gjerë, për të mobilizuar pranimin e këtij procesi nga publiku dhe për të parandaluar polarizimet në grup dhe tensionet ndëretnike që mund të rezultojnë nga keqkuptimi i domedhënies së marrëveshjeve të arritura.

Për më tepër, një mësim i rëndësishëm i nxjerrë nga rajoni është shmangia e një skenari të ngjashëm me Bosnjën për sa i përket ndarjes etnike dhe tensioneve ('Bosnjëzimi' i Kosovës). Për më tepër, pjesëmarrësit shprehën shqetësimin se komunitetet tjera joshumicë (përveç serbëve) janë të margjinalizuara, të anashkaluara dhe të pa përfshira në procesin e dialogut dhe pajtimit. Pothuajse ¼ e pjesëmarrësve shprehën nevojën për dialog ndër-etnik brenda Kosovës.

Vullneti politik i kufizuar

Disa pjesëmarrës kanë ndarë shqetësimin se nga një anë, humbja e vullnetit politik në zbatimin e politikave kyçe, dhe nga ana tjetër, marrja e vendimeve të njëanshme, kanë rezultuar në stagnim dhe dëmtim të komunikimit transparent, duke e ulur kështu besimin e publikut ndaj procesit. Kjo shihet në kombinim me ndryshimet e shpejta politike dhe ndryshimet e shpeshta në strukturën e qeverisë së Kosovës. Disa nga të intervistuarit konsiderojnë se ka tendenca të ketë një mospërputhje mes kërkesave të shoqërisë dhe aktiviteteve të shoqërisë civile me qeverinë e cila, pavarësisht se udhëheqë zbatimin, duket se nuk i jep rëndësi të duhur monitorimit të procesit.

Roli i Bashkimit Evropian

Në përgjithësi, aktorët ndërkombëtarë duket se kanë një ndikim të fuqishëm në proceset e zbatimit, duke siguruar dhe garantuar mbështetje për qeveritë dhe shoqërinë civile në Kosovë dhe në Serbi. Edhe pse zbatimi është bërë pjesë e procesit të integritimit Evropian, sipas disa të intervistuarve, integrimi i çështjes së zbatimit në përpjekjet për anëtarësim në BE nuk ka sjellur rezultate të dukshme në adresimin e sfidave. Është e rëndësishme të theksohet se pjesëmarrësit shohin ndërlidhje mes mungesës së vullnetit politik dhe mungesës së kapaciteteve të qeverisë për zbatim

me reagime të papërshtatshme nga BE-ja.⁴⁸ Po ashtu, ja vlen të përmendet se disa nga të intervistuarit e kanë konsideruar pushtimin e Ukrainës dhe zhvillimet gjeopolitike si një momentum për zgjidhjen e problemeve në Ballkanin Perëndimor dhe kanë shtyrë arritjen e marrëveshjes në vitin 2023.

1.3. Iniciativat e Modelit II në Kosovë dhe roli i aktorëve të ndryshëm

Shumica e pjesëmarrësve ishin në gjendje të kujtonin iniciativat e kaluara që kanë pasur për qëllim mbështetjen e negociatave. Sipas shumë pjesëmarrësve, proceset e Modelit II në Kosovë kanë *plotësuar* dhe *mbështetur* negociatat dypalëshe dhe shumëpalëshe në nivel politik.

Qëllimet dhe funksionet

Iniciativat e Modelit II në Kosovë kanë luajtur role të ndryshme në periudha të ndryshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për t'u diskutuar pasi që funksionet e ndara (të izoluar), nuk mundësojnë pjesëmarrjen kuptimplotë të grave në proceset e paqes. Në vend të asaj, funksionet dhe objektivat e ndryshme e ndërtojnë procesin që ka të bëjë me përfshirjen kuptimplotë të grave.

Analizat e të dhënave kanë treguar se shoqëria civile është e kufizuar në angazhimin e drejtpërdrejtë në procesin e dialogut. Duke punuar *paralelisht* me Modelin I, shoqëria civile kryesisht ka iniciuar nisma dhe aktivitete ad hoc, të bazuara në çështjet e pajtimit, ballafaqim me të kaluarën, dialogun e brendshëm ndërmjet Shqiptarëve dhe Serbëve të Kosovës, monitorimin e proceseve të dialogut dhe zbatimit duke kërkuar llogaridhënie nga qeveria, dhe informimin e publikut. Në Kosovë, aktorët e Modelit II kanë luajtur funksion mbikqyrës në shumicën e rasteve, duke i mbajtur qeveritë përgjegjëse për veprimet e tyre në procesin e paqes, dhe duke u ushtruar presion figurave politike në Kuvend që të raportojnë për progresin (Intervista 35). Për më tepër, shoqëria civile ka punuar në mënyrë aktive për të rritur transparencën duke lehtësuar dialogun brenda Kosovës, mes komuniteteve të ndryshme. Një shembull është formati paralel i Modelit II Prishtinë-Beograd ndërmjet aktorëve të shoqërisë civile nga të dyja palët. Përveç kësaj, Modeli II është angazhuar në përcaktimin e agjendës duke rritur vetëdijësimin e publikut për çështje kritike që shpesh janë anashkaluar në dialog (si çështja e personave të zhdukur, viktimave e përdhunimit,

⁴⁸ Edhe BE-ja është kritikuar për qëndrime të favorshme ndaj serbëve gjatë negociatave dhe zbatimit..

dhe dokumentimi i krimeve të luftës). Po ashtu, është theksuar roli i Modelit II në *mbështetjen e procesit formal të* negociatave përmes monitorimit dhe punës cilësore të shoqërsë civile duke përfshirë avokimitn dhe raporte te hulumtimit si pjesë e dialogut (shih më poshtë më shumë mbi transferin).

Sfidat

Ka iniciativa të rralla që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e marrëveshjeve. Shoqëria civile mbështetet fuqishëm në fondet e donatorëve dhe mungesa e aktiviteteve shihet si rezultat i mungesës së fondeve.

Në shumë raste, puna e shoqërisë civile është penguar nga mungesa e informacionit, transparencës dhe komunikimit. Kjo komplikohet edhe më tej nga rastet e dëmtimit të komunikimit ndërmjet grupeve punese ose ndërmjet aktivistëve dhe aktorëve politikë. Një nga pjesëmarrësit madje shprehu shqetësimin se shoqëria civile në Kosovë dhe në rajon tani janë më pak proaktive në gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta në krahasim me përpjekjet e kaluara (Intervista 2). Kufizimet e financimit theksohen si një faktor kryesor që kontribuon në aktivitetit të limituar të shoqërisë civile, duke kufizuar rrjedhimisht mundësitë që gratë dhe të rinjt të përfshihen në aktivitetet e ndërtimit të paqes.

Të intervistuarit po ashtu kanë shprehur shqetësime për ndërhyrjet politike, rezistencën dhe dështimin për t'i dhënë hapësirë aktiviteteve të Modelit II, gjë që kufizon ndikimin e proceseve të Modelit II.

Efektiviteti dhe ndikimi në proceset formale

Kur bëhet fjalë për efektivitetin e veprimeve të kaluara dhe kontributin e shoqërisë civile, pothuajse 1/3 e pjesëmarrësve mendojnë se ka pasur përpjekje dhe ndikim të kufizuar të nismave që kanë tërhequr vëmendje të mjaftueshme në shoqëri dhe qarqe politike. Modeli II ishte relativisht më aktiv para vitit 2019. Marrëveshja e Brukselit është konsideruar si një katalizator për më shumë bashkëpunim ndëretnik në mes të shoqërisë civile në veri të Kosovës me pjesën tjetër të vendit. Disa pjesëmarrës e interpretojnë të kaluarën si një mundësi e humbur për qeverinë dhe shoqërinë civile në arritjen e rezultateve me komunitetin serb (më 2015-18), duke rezultuar kështu në zvogëlimin e hapësirës për aktivitetet e Modelit II nga viti 2019 (Intervista 13). Të tjerë mendojnë

se iniciativat e kaluara kanë qenë të dizajnuara për të pasur një ndikim të kufizuar në procesin formal të paqes (përfshirë ato për përfshirjen e grave), dhe që ishin të kufizuara në një grup të vogël aktorësh të shoqërisë civile (veçanërisht nga Prishtina) (Intervista 24), (Intervista 21), (Intervista 27). Aktivitetet e kaluara artistike dhe kulturore janë përmendur si shembuj suksesi të iniciativave që kanë bashkuar pjesë të ndryshme të shoqërisë (Intervista 13).

Ka perceptime të ndryshme përsa i përket transferit nga Modeli II në Modelin I, ku disa aktorë perceptojnë një transfer të suksesshëm, megjithëse të kufizuar, ndërsa të tjerët nuk perceptojnë ndonjë transfer të suksesshëm. Kjo mungesë e transferit i atribuohet kryesisht qeverive të Kosovës dhe Serbisë, si dhe BE-së, për shkak të qasjes së tyre e cila konsiderohet si jotransparente dhe jo përfshirëse për shoqërinë civile, gratë dhe komunitetet jo-shumicë. Për më tepër, theks i veçantë i është kushtuar rolit të zhvillimeve politike të cilat ndikojnë negativisht në punën e vazhdueshme të shoqërisë civile në terren. Sulmi terrorist kundër Policisë së Kosovës në Banjskë është përmendur shpesh si shembull që ka lënë në hije të arriturat. Konkretisht, për qeverinë e Kosovës, sfidat shtrihen edhe në ndryshimin e përfaqësuesve politikë pasi që nuk ka transfer të mirëfilltë të informacionit dhe kujtesës institucionale, gjë që zvogëlon rolin e punës së bërë nga shoqëria civile. Konkretisht për qeverinë e Serbisë, sfidat shtrihen në përhapjen e retorikave nacionaliste që dëmtojnë tutje marrëdhëniet ndëretnike. Rastet pozitive të transferit i referohen transferit *nga poshtë* - nga iniciativat e Modelit II tek publiku (Modeli III).

Mbështetja Ndërkombëtare e proceseve të paqes të Modelit II

Të intervistuarit kanë theksuar rolin e rëndësishëm të përkrahësve ndërkombëtarë në forcimin e shoqërisë civile në Kosovë. Përsa i përket mbështetjes ndërkombëtare, misionet diplomatike kryesisht ishin të përfshira në financimin dhe lehtësimin e aktiviteteve/iniciativave që synonin komunikimin dhe bashkëpunimin ndëretnik. Vëmendje e veçantë u është kushtuar aktiviteteve dhe iniciativave që kanë për qëllim mbështetjen e komunitetit serb të Kosovës në çështje si arsimit, qasja në kujdesin shëndetësor dhe çështjet e përditshme. Iniciativat e Modelit II që kanë targetuar aktorë të ndryshëm nga Kosova dhe Serbia janë financuar dhe mbështetur nga qeveria Zvicerane (duke ofruar ekspertizë teknike, duke mbajtur takime të Modelit I.5). Një aktor tjetër ndërkombëtar, Ministria e Punëve të Jashtme të Suedisë, u veçua për rolin e saj në mbështetjen e dialogut në Kosovë (Intervista 13). Megjithatë, mbështetja ndërkombëtare nga donatorë të tjerë, si

ambasadat e Quintit në Kosovë, Ambasada Norvegjeze në Kosovë dhe të tjerë, po ashtu janë përmendur nga të intervistuarit. Mbështetja ndërkombëtare gjithashtu ka rezultuar në angazhim më aktiv të qeverisë së Kosovës dhe Serbisë (Intervista 4). Angazhimi specifik me aktorët kombëtarë dhe lokalë po ashtu ka përfshirë **ndërtimin e koalicionit** për të mbështetur procesin e ngecur dhe për të organizuar aktivete për palët e përfshira (p.sh. Samiti i Kosovës për Paqe dhe Demokraci).

2. Përfaqësimi dhe përfshirja e grave të Kosovës në proceset e paqes

2.1. Përfshirja e grave të Kosovës në proceset e Modelit I

Roli i grave të Kosovës në promovimin e të drejtave të grave, fuqizim, dhe pjesëmarrje politike është njohur pothuajse nga të gjithë pjesëmarrësit. Megjithatë, roli dhe përfshirja aktive rrallëherë shtrihet në angazhimin e drejtpërdrejtë në proceset formale të paqes. Një përgjigje e zakonshme ndaj kësaj pyetjeje ishte "*Nuk e di ndonjë*" (Intervista 20, Intervista 33). Edhe kur Rezoluta 1325 e OKB-së përmendet si një shembull i zyrtarizimit të angazhimit institucional për përfshirjen e grave në nivele të ndryshme në proceset e paqes, përpjekjet mbeten në letër pa u përkthyer në zbatim.

Emra specifike të njohur nga pjesëmarrësit nuk kanë përfshirë vetëm kryenegociatoren Edita Tahiri, por edhe gratë negociatore kyçe në Bisedimet e Vjenës dhe në ndërtimin e paqes para procesit të Brukselit, duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet grave të Kosovës dhe Serbisë. Një punë e dukshme është parë në avokimin për të mbijetuarat e dhunës seksuale në Kosovë, me rastin e emërimit të të dërguarës të posaçme presidenciale për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, si shembull pozitiv. Edhe pse Edita Tahiri është një figurë e njohur dhe si Kryenegociatore në fazat e mëparshme të dialogut, duke arritur progres në procesin formal të Modelit I gjatë mandatit të saj, janë ngritur shqetësime se kontributet e Tahirit mund të jenë marginalizuar ose anashkaluar. Disa theksojnë gjithashtu faktin se përparimet në dialog kanë ndodhur gjatë periudhave kur gratë si Catherine Ashton dhe Federica Mogherini (nga pala e BE-së), ishin të përfshira. Që nga zonja Tahiri, përveç rolit indirekt të grave presidente, duke përfshirë Presidenten Osmani dhe Presidenten Jahjaga, ka mungesë të grave në Modelin I nga ana e Kosovës.

Megjithatë, një numër pjesëmarrësish, duke u mbështetur në perspektiva krahasuese, kanë ndarë mendimin se përvoja i përket përfshirjes së grave në proceset e paqes në Kosovë (dhe Serbi), ka pasur përparime të mëdha që mund të konsiderohen më gjithëpërfshirëse sesa kontekstet tjera (Intervista 31), (Intervista 11), (Intervista 4).

Në politikën kosovare, zgjedhjet e mëparshme lokale dhe kombëtare kanë parë një rritje të përfaqësimit të grave si rezultat i zbatimit të kuotave gjinore prej 30%. Në zgjedhjet e fundit parlamentare ka pasur progres të dukshëm në përfaqësimin e grave, suksesi ky që ka pasur mbështetje të reduktuar në kuota për sigurimin e vendeve në Kuvend. Megjithatë, deri më tani, përfaqësimi i grave ka qenë afër pragut. Në mesin e të intervistuarve ekziston një ndjenjë e përhapur se ndërsa sistemet e kuotave kanë rritur numrin e grave në parlamente dhe kabinete, prania e tyre shpesh nuk përkthehet në pjesëmarrje domethënëse. Pavarësisht marrjes së këtyre pozitave, gratë mund të ndihen të përjashtuara nga qarqet vendimmarrëse. Edhe gratë në pozita udhëheqëse në qeveri dhe Kuvend përballen me vështirësi për të ndikuar në agjendën e partive politike dhe institucioneve, gjë që tregon prezencën e një hendeku të vazhdueshëm gjinor në mjediset politike dhe institucionale. Kjo konfirmon debatet e fundit që, ndërsa përfshirja sasiore është e rëndësishme, prania e thjeshtë fizike e grave nuk mundëson transformimin e strukturave patriarkale, duke theksuar që kuotat duhet të kombinohen me masa të tjera të përkohshme mbrojtëse për të arritur përfshirjen.

Në përgjithësi, gjersa disa aktorë të shoqërisë civile dhe gra që ishin të përfshirë në mënyrë aktive në aktivitetet e Modelit I ose Modelit II kanë njohur rolet dhe kontributet e grave në proceset e paqes, aktorët që nuk ishin të përfshirë drejtpërdrejt në negociatat e paqes ose iniciativat e shoqërisë civile kanë pasur vështirësi në navigim të dinamikave të kalura dhe të identifikojnë rolet të veçanta të ka luajtur gratë. Faktorët që kontribuojnë në përjashtimin e grave do të shtjellohen më tej në nën-seksionin vijues.

2.2. Faktorët kufizues në përfshirjen e grave

Shqyrtimi i lidhjeve mes segmenteve të koduara në dokument tregon se faktorët kufizues kryesorë të përmendur vazhdimisht për shpjegim të mungesës së përfshirjes së grave në proceset e paqes janë:

- 1) Qëndrimet dhe pritshmëritë shoqërore rreth roleve gjinore;
- 2) Qëndrimet në mjediset institucionale dhe indiferenca nga shteti dhe aktorët politikë;
- 3) Nënperfaqësimi i grave në vendimmarrje dhe negociata formale.

Gratë shihen si më të dobëta dhe jo të gatshme për të marrë pjesë në dialogun i cili shihet si një “proces i burrave” (Intervista 36). Disa pjesëmarrës shprehën pikëpamjen se mentaliteti është duke ndryshuar ngadalë (p.sh., postet e dy presidenteve gra dhe zgjedhja e grave në kuvend pa kuotë). Megjithatë, theksohet se gratë mbajnë barrën më të rëndë shtëpiake, duke përfshirë punët e shtëpisë dhe rritjen e fëmijëve, gjë që ndikon në karrierën e tyre duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në politikë. Për më tepër, perceptimi negativ i publikut për dialogun dhe kontestimi publik ndikon në hezitimin e grave për t'u asociuar me të, veçanërisht pasi ato gjykohen më shumë dhe përballen me pasoja negative më të mëdha sesa burrat. Elitizmi është një tjetër vëzhgim, ku qeveria kritikohet për përjashtimin e grave dhe komuniteteve të tjera joshumicë nga procesi.

Faktorët e tjerë që janë theksuar vazhdimisht, duke vënë në dukje sfidat kryesore për përfshirje janë kostoja e lartë politike dhe shqyrtimi në i lartë publik i grave në krahasim me burrat, portretizimi negativ nga media, mungesa e motivit nga akteret gra, mungesa e përfshirjes në shoqëri, mungesa e dukshmërisë së aktoreve gra në proceset e paqes dhe qasja e kufizuar në ekonomi dhe pronë.

Tabela e mëposhtme tregon kodet emergjente të bazuara në frekuencën, qëndrueshmërinë dhe lidhjen për të shpjeguar barrierat, të karakterizuara si faktorë procesi dhe konteksti që kufizojnë përfshirjen e grave në proceset e paqes:

Tema	Kodet e shfaqura
Faktorë procesi	Nënperfaqësimi në vendimmarrje dhe negociata formale (veçanërisht mungesa e konsultimeve me aktorët lokalë)
	Indiferenca nga shteti dhe aktorët politikë
	Përzgjedhja e bazuar në numër për pozicione drejtuese

	Barrierat për gratë në mjediset institucionale
	Mungesa e strategjive të përfshirjes dhe strukturave mbështetëse
Faktorë kontekstual	Qëndrimet dhe pritshmëritë shoqërore rreth roleve gjinore
	Kostoja e lartë politike dhe shqyrtimi më i lartë publik sesa homologët burra, duke rezultuar në mungesë motivimi për përkushtim
	Mungesa e ndjeshmërisë gjinore
	Mungesa e dukshmërisë dhe njohja e kontributit të grave në proceset e paqes
	Qasje e kufizuar në burime ekonomike dhe pronë

Tabela 1. 5 Faktorët kryesor të procesit dhe të kontekstit në përfshirjen e grave në proceset e paqes

2.3. Përfshirja e grave në Modelin II dhe transferi nga Modeli II në proceset e Modelit I

Ekziston një mungesë e përgjithshme e njohurive për iniciativat e kaluara për ndërtimin e paqes që kishin për qëllim përfshirjen e grave, gjë që tregon shenja të përpjekjeve të kaluara të limituara ose mungesës së dukshmërisë për iniciativat që janë ndërmarrë. Bazuar në reflektimet e përgjithshme, sfidat me të cilat përballen gratë e angazhuara në mënyrë aktive me vendimmarrësit dhe aktorët e Modelit I, në Kosovë dhe Bashkim Evropian, kanë qenë të rëndësishme. Gratë ishin të angazhuara në hapësirën e Modelit II, por përpjekjet dhe kontributet e tyre nuk janë marrë parasysh nga aktorët e Modelit I. Aktoret gra, të angazhuara më parë në iniciativa për ndërtimin e paqes, shprehin zhgënjim në ndryshimin e shpejtë të qëndrimeve të negociatorëve dhe në luftën për njohje. Kjo nënvizon një rezistencë kundër përfshirjes së vërtetë, duke zbuluar nevojën për përpjekje të vazhdueshme për të larguar barrierat dhe për të nxitur një mjedis më të barabartë dhe më vlerësues për kontributin e qenësishëm të grave në proceset vendimmarrëse.

Rrjetet e Grave

Rrjeti i Grave të Kosovës

Përpjekjet e Rrjetit të Grave të Kosovës janë të njohura në mesin e palëve të ndryshme të interesit për ndikimin e tyre pozitiv në avokimin dhe nxitjen për përfshirjen e grave në proceset e kaluara të paqes. Si rezultat i mobilizimit, gratë janë konsultuar me negociatorët kryesorë dhe kanë avokuar për përfaqësim të barabartë në negociata në përputhje me Rezolutën 1325. Përtej faktorëve të kontekstit dhe mbështetjes ndërkombëtare, ky rol aktiv i është kredituar motivit të lartë të grave për t'u vetëorganizuar dhe përkushtimit të tyre për të ushtruar ndikim në dialog.

Transferi në mes palëve në Kosovë

Përvoja dhe njohuritë e kaluara tregojnë se transferi nga Modeli II në Modelin I është sfidues për shkak të natyrës konfidenciale të negociatave, hezitimit dhe kufizimeve të qeverisë për të pasur diskutime dhe bashkëpunim me aktorët e Modelit II, si dhe për shkak të ndryshimeve të shpejta politike dhe joefektivitetit të përpjekjeve të kaluara. Faktorët si nënpërfaqësimi i grupeve në proceset formale kontribuojnë veçanërisht në këtë shkëputje. Shumë të intervistuar e kanë përshkruar Modelin I dhe Modelin II si procese *paralele*, pavarësisht nga një ndjenjë e përgjithshme se roli thelbësor i të parës është të *komplimentojë* të dytën. Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe të shoqërisë civile, përvoja e kaluar e aktorëve të shoqërisë civile të cilët kanë punuar ngushtë me përfaqësuesit e Kuvendit, ishte me zhgënjime për ndryshimet e shpejta politike që kanë komplikuar ndjeshëm transferin e njohurive, ekspertizës dhe ndikimit nëpër Modele.

Megjithatë, ka pasur shembuj pozitivë siç janë propozimet e politikave, konsultimet dhe seminarët për zgjidhjen e problemeve. Në periudha të caktuara, shoqëria civile ka luajtur një rol aktiv përmes kontributit në këshillim dhe pjesëmarrje në takimet për zgjidhjen e problemeve krahas BE-së (Modeli I.5). Takimet e rregullta ndërmjet shoqërisë civile dhe BE-së kanë lehtësuar më tej komunikimin dhe shkëmbimin. Periudha 2015-2018 në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja po ashtu është quajtur "periudhë e artë" e transferit (Intervista 14). Një nga pjesëmarrësit ka përmendur si shembull pozitiv, kryesisht si rezultat i avokimit nga komuniteti, përfshirjen e çështjes së përdhunimeve gjatë luftës dhe çështjes së personave të zhdukur në dialog (Intervista 32). Megjithatë, duhet theksuar se përvoja e grave të përfshira në shoqërinë civile gjatë takimeve

me përfaqësuesit e shtetit ka qenë e tillë ku ata kanë folur, duke mos u lënë shumë hapësirë grave për të shprehur nevojat dhe sugjerimet e tyre (Intervista 32).

2.4. Përfshirja e grave në zbatim

Ekziston një gamë e gjerë perspektivash për rolin e grave në Kosovë, që nga përfshirja e limituar e grave në proceset e paqes në Modelin I dhe Modelin II e deri te roli udhëheqës i grave brenda shoqërisë civile. Megjithatë, kur bëhet fjalë për zbatimin, ngjashëm me negociatat, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e grave mbetet e kufizuar dhe të intervistuarit kishin njohuri dhe kuptim të limituar për përfshirjen e tyre në procesin e zbatimit (përveç Edita Tahirit si Kryenegociatore). Zbatimi, i cili ka natyrë komplekse dhe shumëstresore me modalitete të ndryshme përfshirjeje, shpesh të ngjashme me kontekstin në Kosovë, perceptohet si një proces nga lart-poshtë, reflektues i dinamikave të pushtetit të ndikuara nga qëndrimet shoqërore. Një rast i rrallë i angazhimit të grave në zbatimin e marrëveshjeve përfshin punën brendaparlamentare në formë të deklaratave, rekomandimeve, sqarimeve dhe opinioneve nga deputetet gra (Intervista 38). Për sa i përket angazhimit të tërthortë në zbatim, gratë janë aktive në hulumtim dhe avokim por nuk ka njohje për iniciativa e udhëhequra nga gratë që mbështesin zbatimin (Intervista 13).

3. Drejt proceseve gjithëpërfshirëse në Kosovë

3.1. Pikat hyrëse dhe rekomandimet strategjike për të rritur përfshirjen e grave në proceset Modelin II

Rëndësia e përfshirjes së grave në përparimin e proceseve të ngecura ishte një nga pikat kyçe që është shfaqur mbi fuqinë potenciale për të dalur nga stagnimi. Në lidhje me rolin dhe kontributin e ardhshëm të Modelit II, pjesëmarrësit theksuan potencialin për të qenë 'informativ' (Intervista 40), (Intervista 18), duke nxitur 'koordinimin' dhe 'bashkëpunimin' (Intervista 27) mes aktorëve, duke qëndruar 'të pavarur' dhe 'neutral' (Intervista 18). Pjesëmarrësit theksuan bashkëpunimin mes qeverisë dhe shoqërisë civile për të siguruar që ka përfaqësim të duhur të nevojave dhe kërkesave të komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Për më tepër, thirrjet për më shumë transparencë në zhvillimet e dialogut dhe marrëveshjet e arritura shihen si thelbësore në punën e shoqërisë civile për të informuar publikun e gjerë, për të mobilizuar pranimin e këtij procesi nga publiku dhe për të parandaluar polarizimet në grup dhe tensionet ndëretnike që mund të rezultojnë nga keqkuptimi

i domedhënies së marrëveshjeve të arritura, në veçanti për çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Sërbe. Për më tepër, thirrjet për përfshirjen e agjendës gjinore, me fokus për të sjellur në tryezën e negociatave çështjen e dhunës seksuale gjatë kohës së luftës, krahas thirrjeve për më shumë pjesëmarrje të grave në ekipin e negociatorëve, janë të përhapura.

Duke u bazuar në pikëpamjet e pjesëmarrësve në studim dhe analizën e mëtejme të të dhënave, pikat e mundshme hyrëse dhe opsionet për të përparuar dhe adresuar çështjen e përfshirjes së grave në procesin e paqes në kuadër të Modelit II, dhe zgjerimi i transferit nga Modeli II në Modelin I mund të përfshijë të sugjerimet e mëposhtme:

- **Nevoja për të rimenduar dhe ndryshuar qasjen dhe strategjinë:** strategjia është më pak efektive kur synon aktorë ndërkombëtarë që tashmë mbështesin përfshirjen. Përkundrazi, ka nevojë për avokim ndaj aktorëve vendorë me fuqi vendimmarrëse. Hartoni strategji për transfer duke synuar aktorë politikë dhe përfaqësuesit e rinj të BE-së (pas qershorit 2024).
- **Pronësia lokale dhe qasja ndërsektoriale në zhvillimin e kriterëve për përfshirje:** ka nevojë për të përmirësuar përfshirjen e grupeve të ndryshme që do të ndejnë pronësi mbi procesin. Kriteret e përfshirjes duhet të përfshijnë aspekte etnike, fetare, gjinore dhe të moshës në mënyrë që të mundësohet angazhim i qëndrueshëm dhe i domosdoshëm i ndërmjetësuesve lokalë, grave dhe organizatave të shoqërisë civile.
- **Ndërtimi i besimit dhe pajtimi në nivelin konunitar (dhe rritja e angazhimit lokal):** shoqëria civile duhet të angazhohet në terren me komunitetin Serb (duke rritur ndërgjegjësimin dhe lehtësimin e ndërveprimit të drejtpërdrejtë ndërmjet qeverisë dhe komuniteteve lokale). Kjo mund të nënkuptojë gjithashtu vazhdimin e bisedimeve përtej procesit të udhëhequr nga BE. Për sa i përket qasjes ekzistuese, një pjesëmarrës i intervistuar, që punonte në programe edukative dhe humanitare, kritikoi natyrën e ndërhyrjeve të tanishme, të para si të shpërndara dhe në nivel jo të duhur, dhe sugjeroi krijimin e një organizate ombrellë (si një aktor i rëndësishëm i Modelit II) që punon drejt pajtimit të serbëve dhe shqiptarëve (Intervista 40).
- **Përmirësimi i transparencës dhe komunikimit:** pasi një nga problemet kryesore është mungesa e transparencës e cila ndikon substancialisht në organizimin e duhur të shoqërisë civile për të influencuar zbatimin (Intervista 25), komunikimi dhe transparenca e përmirësuar në proces mund të luajnë një rol kryesor në ndryshimin e sjelljeve dhe në

mundësimin e proceseve gjithëpërfshirëse të zbatimit. Parandalimi i sfidave në komunikim për të përmirësuar koordinimin mes të gjitha niveleve dhe për të mundësuar përfshirjen në zbatim. Duke marrë parasysh konfidencialitetin e formatit, përmirësimi i komunikimit mund të përfshijë konsultime dhe shkëmbime mes organizatorëve të dy modeleve.

- **Zhvillimi i strategjive të avokimit në mesin e grave paqëndruesive të Kosovës:** gratë paqëndruese në Modelin II mund të ndjekin strategji të *brendshme*, duke përfshirë shkëmbime të drejtpërdrejta me ndërmjetësuesit ose ekipet negociuese, ose strategji të *jashtme*, të cilat përfshijnë kontaktin me publikun, angazhimin e mediave dhe përpjekjet e avokimit. Periudha e lobimit aktiv nga gratë mund të bëjë një ndryshim të madh (për shembull, gratë e Kosovës mund të hartojnë strategji dhe taktika avokuese përballë të përfaqësuesve të ardhshëm të BE-së).
- **Mekanizmat konsultativ mes aktorëve të Modelit I dhe Modelit II:** konsultimet, të mbështetura nga negociatorët dhe ndërmjetësuesit, lidhin drejtpërdrejt negociatorët me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë gratë, duke ofruar një platformë vendimtare për grupet që zakonisht përjashtohen nga vendimmarrja në nivel të lartë për të shprehur nevojat dhe shqetësimet e tyre (për shembull, dialogu i udhëhequr nga Edita Tahiri, një kryenegociatore nga Kosova, mund të vazhdojë me biseda që përfshijnë gra të tjera). Vazhdimësia në proces mund të përfshijë pjesëmarrjen e hershme të grave në përcaktimin e agjendës dhe komunikimin e rregullt, duke ndihmuar potencialisht në shmangien e pengesave me të cilat janë ballafaquar më parë gratë aktore nga shoqëria civile.
- **Ndryshimi i fushëveprimit të agjendës dhe adresimi i çështjeve të ndjeshme gjinore:** pas vlerësimit të përfshirjes dhe ndikimit kuptimplotë të grave në proceset e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, raporti arrin në përfundimin se prania sasiore e grave, edhe në pozita udhëheqëse, nuk kanë një kapacitet transformues pa adresuar problemet e ndjeshme gjinore që vazhdojnë në mjediset formale dhe joformale. Kjo përfshin sigurimin e masave që adresojnë nevojat specifike të burrave dhe grave. Përveç kësaj, është e rëndësishme të adresohet dimensionin gjinor i politikës së sigurisë, veçanërisht me përparimin e Kosovës drejt zbatimit të planeve të veprimit për gratë, paqen dhe sigurinë.

3.2. Zbatimi dhe Monitorimi

Perspektivat e ndryshme janë shfaqur përsa i përket implementimit, duke reflektuar kështu opinione të ndryshme se si të adresohen sfidat aktuale. Disa pjesëmarrës shprehën nevojën për të imponuar sanksione ndaj palëve me qëllim që të adresohen shkeljet dhe mos-përmbushjet, duke e konsideruar këtë si të rëndësishme për mbarëvajtjen e integritetit të marrëveshjeve. Përveç kësaj, disa ndajnë pikëpamjen për nevojën për presion ndërkombëtar, që nënkupton përfshirjen më të gjerë të SHBA-së ose BE-së, dhe po ashtu kushtëzim më të madh nga BE-ja, e cila, duke iu përmbajtur marrëveshjeve ekzistuese, mund të përdorë ndikimin e që ka për të shtyrë tutje zbatimin. Sa i përket rolit të shoqërisë civile, ndërsa disa njohin rolin qëndror të tyre, të tjerët mendojnë se roli i shoqërisë civile duhet të jetë i kufizuar në monitorim, avokim dhe masa për të ndërtuar besim.

Sa i përket përfshirjes, ekziston një konsensus në rritje ndaj nevojës për t'i dhënë formë të re zbatimit me një qasje nga poshtë-lart, me qendër qytetarët. Kjo përfshinë angazhimin aktiv me palët e interesit, duke përfshirë konsultime me organizatat e grave nga shoqëria civile dhe përfaqësues të komunitetit, për të siguruar që zërat dhe perspektivat e ndryshme dëgjohen dhe përfshihen në proceset e vendimmarrjes. Duke prioritetizuar përfshirjen dhe dialogun kuptimplotë me aktorët kryesorë, përpjekjet për zbatim mund të adresojnë nevojat dhe aspiratat e komunitetit më të gjerë, duke kontribuar përfundimisht në legjitimitet dhe efektivitet më të madh në arritjen e paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjithashtu njihet se monitorimi i progresit në zbatim mund të hapë rrugën për një angazhim më gjithëpërfshirës. Reflektimet e përgjithshme mbi mënyrat se si të vazhdohet me monitorimin përfshijnë dy pozicione të ndryshme: 1. Korniza e monitorimit që tashmë ekziston (duke përfshirë mekanizmin e BE-së që është pjesë e proceseve të integritetit evropian), të cilit duhet t'i përmbahen dhe t'a zbatojnë; 2. Ekziston nevoja për të kërkuar zgjidhje dhe instrumente të reja për të përmirësuar procesin e monitorimit dhe zbatimit, i cili është jo transparent dhe nuk ka mjete për të matur progresin, veçanërisht në nivel lokal.

Fushat e propozuara për përmirësim në monitorimin e progresit mund të përfshijnë:

- **Komiteti gjithëpërfshirës i përbashkët i mbikëqyrjes:** ky komitet mund të përfshijë shoqërinë civile, gratë paqendërtuese, qeverinë, përfaqësues ndërkombëtarë nga BE-ja dhe vendet Perëndimore (disa veçanërisht theksojnë rëndësinë dhe nevojën për përfshirjen e BE-së në monitorim; të tjerët vënë në dukje pronësinë lokale dhe rolin e rëndësishëm të grave). Aktorët e shoqërisë civile potencialisht mund të drejtojnë vlerësimin e nevojave dhe të raportojnë zhvillimet.
- **Krijimi i indikatorëve më konkretë dhe të lokalizuar për monitorim kërkon përshtatjen e indikatorëve që pasqyrojnë nevojat, prioritetet dhe kapacitetet e komuniteteve lokale duke siguruar pjesëmarrje dhe pronësi kuptimplotë përgjatë procesit.** Kjo mund të përfshijë renditjen dhe përcaktimin e indikatorëve për të funksionalizuar Aneksin e Zbatimit.
- **Bashkëpunim i përmirësuar dhe në kohë aktuale ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile:** bashkëpunimi shihet të jetë thelbësor në zhvillimet në vijim dhe në vendosjen e procedurave formale. Një zgjidhje e mundshme mund të jetë krijimi i një marrëveshjeje ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë për të rritur përfshirjen dhe për të adresuar çështjen e mungesës së transparencës në zbatimin e marrëveshjeve. Për më tepër, përfshirja e hershme e grave në zbatimin e marrëveshjeve të paqes Kosovë-Serbi vlerësohet të jetë e rëndësishme, bashkë me promovimin e përfshirjes, në vendosjen e një bashkëpunimi të qëndrueshëm.⁴⁹

3.3. Angazhimi i aktorëve ndërkombëtarë në mbështetjen e proceseve përfshirëse

Ka mendime të ndryshme në lidhje me rolin e komunitetit ndërkombëtar në përparimin e dialogut dhe rritjen e gjithëpërfshirjes së këtij procesi përmes thirrjeve për përfshirjen e grave, të rinjve, komuniteteve jo-shumicë dhe personave të prekur drejtpërdrejt nga konflikti. Financimi i shoqërisë civile gjithashtu shihet si një pikë kyçe për mbështetjen ndërkombëtare në proceset e paqes, megjithatë, vërehet se kjo përfshirje duhet të jetë kuptimplotë në mënyrë që të evitohet mbështetja e organizatave të cilat punojnë në nivel sipërfaqësor. Ndërsa, ekziston një konsensus i përgjithshëm

⁴⁹ Për shembull, rasti i Kolumbisë tregon se pjesëmarrja e grave në fazat e hershme të përcaktimit të agjendës së një procesi paqeje mund të jetë efektiv për ta bërë procesin e paqes më të qëndrueshëm.

që komuniteti ndërkombëtar duhet të rifillojë dialogun e ngecur, dhe që mund të llojë më shumë për përfshirjen e grave dhe komuniteteve jo-shumicë, ekziston një njohje se presioni që vjen nga jashtë nuk është një zgjidhje e qëndrueshme. Ndryshimet duhet të vijnë nga brenda vendit dhe duhet të ketë pronësi lokale në proceset e promovimit të përfshirjes. Për shembull, ka pasur kritika lidhur me komunikimin e Përfaqësuesit Special të BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë me grupet e grave në Kosovë, krahas standardeve të dyfishta të Bashkimit Evropian në qasjet ndaj Kosovës karshi Serbisë. Bazuar në përvojat krahasuese ndërkombëtare, niveli i mbështetjes, vëmendja dhe përgjegjësia e aktorëve ndërkombëtarë kanë tendencë të jenë faktorë kyç që mundësojnë ose kufizojnë përfshirjen e grave, dhe intervistat sugjerojnë se mund të bëhet më shumë në këtë drejtim.

Rekomandime Strategjike për Aktorët Ndërkombëtarë

- Të mbahen konsultime me gra dhe aktorë lokalë për të arritur përfshirje të gjerë, duke bashkëplanifikuar dhe implementuar procese gjithëpërfshirëse.
- Të mbështeten, financohen dhe fuqizohen aktorët lokalë (në ngritjen e vetëdijësisimit, ekspertizës, dhe lehtësimin e përfshirjes së tyre në vendimmarrje në nivelin formal të Modelit D);
- Të promovohet dialogu brenda shtetit dhe mes shteteve, duke lehtësuar komunikimin, ristrukturuar formatin dhe zbatuar iniciativa për ndërtimin e besimit;
- Të vëzhgohet dhe monitorohet progresi dhe të përmirësohet mekanizmi ekzistues i BE-së në bashkëpunim me shoqërinë civile në Kosovë dhe Serbi;
- Të ushtrohet presion ose të ofrohen incentiva për aktorët politikë për përparim të procesit të zbatimit.

Ndërlidhja me Integrimin Evropian dhe Roli i BE-së

Intervistat kanë demonstruar një perspektivë të përbashkët se hapat drejt integritit në Bashkimin Evropian kanë kontribuar ndjeshëm në përparimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo është arsyeja pse, nga njëra anë, disa theksuan domosdoshmërinë e kushtëzimit strikt të BE-së për përparim të qëndrueshëm gjatë fazës së zbatimit. Nga ana tjetër, kishte pikëpamje të ndryshme se integrimi i zbatimit në rrugën e anëtarësisimit në BE nuk ka treguar rezultate të prekshme në tejkalimin e problemeve në zbatim. Duke iu referuar mbështetjes së tyre për proceset e paqes,

aktorët ndërkombëtarë po ashtu i kanë kushtuar rëndësi të madhe të avancimit të procesit për anëtarësimin e Ballkanit Perëndimor në BE.

V. PËRFUNDIMET

Ky studim politikash ka analizuar të dhënat primare të grumbulluara nga intervistat për të paraqitur gjetjet mbi përfshirjen e grave dhe iniciativat e Modelit II në proceset e paqes Kosovë-Serbi. Duke hulumtuar përvojën e kaluar dhe duke marrë parasysh këndvështrime të ndryshme, raporti ka identifikuar faktorët kufizues dhe pikat e hyrjes të mbështetur, përshtatur dhe plotësuar përpjekjet e vazhdueshme për rritjen e përfshirjes së grave.

Si përfundim, gjetjet mbi përjashtimin e grave vërtetojnë nocionin e natyrës ekskluzive të proceseve të paqes Kosovë-Serbi. Po kështu, një sërë faktorësh kufizues (Seksioni 2.2) pengojnë pjesëmarrjen domethënëse të grave në aktivitetet e Modelit I dhe Modeli II. Ndonëse gratë përfaqësohen në pozicione drejtuese, faktorë të ndryshëm kufizues kufizojnë ndikimin e tyre në hapësirat e Modelit I dhe Modelit II. Në të njëjtën kohë, kontributet e identifikuar të grave, ndonëse shpesh janë anashkaluar, janë konsideruar të rëndësishme dhe në përputhje me literaturën dytësore mbi ndikimin pozitiv të angazhimit të grave në proceset e paqes.

Në kontekstin e sfidave të vazhdueshme në Modelin I dhe Modelin II, është kritike të rimendohet procesi i paqes dhe mënyra se si aktorët angazhohen dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Veçanërisht, në kuadër të paqartësisë ekzistuese mbi angazhimet e palëve dhe stagnimit në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit, përpjekjet e Modelit II mund të ofrojnë një rrugë më efektive për ndërtimin e qëndrueshëm të paqes dhe në rritjen e legjitimitetit të procesit të paqes duke nxitur ndjenjën e pronësisë në komunitete. Kjo gjithashtu nënvizon rëndësinë kritike të përfshirjes së grave të Kosovës në modele veçmas, si dhe ndërmjet modeleve, të cilat janë shfaqur si pikë potenciale për thyerjen e ngecjes së tanishme.

Raporti thekson disa pika hyrëse dhe opsione për avancimin e përfshirjes së grave në procesin e paqes në Modelin II dhe lehtësimin e transferit mes modeleve (të paraqitur në seksionin 3.3):

- Rishikimi dhe ndryshimi i qasjes dhe strategjive të përfshirjes në raport me aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë;
- Pronësia lokale dhe qasja ndërseksionale në zhvillimin e kritereve të përfshirjes;

- Nxitja e ndërtimit të besimit dhe pajtimit në nivelin e komunitetit (dhe zgjerimi i angazhimit lokal);
- Përmirësimi i transparencës dhe komunikimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovë;
- Zhvillimi i strategjive avokuese mes grave paqendërtuese të Kosovës;
- Ngritja e mekanizmave konsultativ mes aktorëve të Modelit I dhe Modelit II;
- Ndryshimi i fushëveprimit të agjendës dhe adresimi i çështjeve të ndjeshme gjinore.

Së fundi, përderisa hulumtimi nxori në pah perspektiva të ndryshme mbi kontributet e kaluara të aktorëve ndërkombëtarë për avancimin e dialogut dhe nxitjen e përfshirjes, të intervistuarit shprehën nevojën për angazhim ndërkombëtar (veçanërisht të Bashkimit Evropian) në mbështetjen dhe fuqizimin e shoqërisë civile dhe gratë në Kosovë.

VI. SHTOJCAT

Shtojca A. Udhëzues për intervista

Sfondi/konteksti

1. Pikat kryesore dhe progresi
 - a. Cilat ishin pikat/momentet kritike në proceset e kaluara të paqes? Cilat prej tyre sjellën marrëveshje? A mendoni se marrëveshjet e fundit mund të ofrojnë një kuadër më gjithëpërfshirës për të adresuar sfidat e procesit të paqes të lehtësuar nga BE?
 - b. Çfarë roli kanë luajtur aktorët e shoqërisë civile dhe gratë në proceset e kaluara të paqes? A jeni në dijeni të ndonjë arritjeje në lidhje me rritjen e gjithëpërfshirjes në këto procese? Çfarë shihni si sfida apo barriera të përfshirjes në këto procese të deritanishme?
2. Vlerësimi i proceseve të paqes në Modelin II (*Track II*)
 - a. Ju lutem, a mund të më tregoni për ndonjë iniciativë të Modelit II (*Track II*) në të cilën keni qenë të përfshirë? (Pyetjet vijuese janë me qëllimin tematik dhe mund të pyeten nëse është e nevojshme dhe e përshtatshme)
 - i. Cilat ishin qëllimet/synimet e saj? Çfarë përfshinte në thelb iniciativa?
 - ii. Kur filloi ky projekt? Si u përfshitë? Kush tjetër ishte përfshirë? Cili institucion/organizatë e financoi projektin?
 - b. Si e shihni kontributin e këtyre iniciativave të Modelit II (*Track II*) në rezultatet e ndërtimit të paqes? Dhe si i shihni ato duke u lidhur dhe duke ndikuar në përpjekjet e Modelit I (*Track I*)? Ne jemi të interesuar në konceptin e "transferit". E keni hasur më parë këtë term? (Nëse pjesëmarrësi/ja nuk ka, jepni një shpjegim të shkurtër). Duke iu rikthyer projektit/eve që diskutuam më herët në intervistë, a keni planifikuar të arrini lloje të veçanta transferimesh gjatë këtyre nismave dhe në çfarë mase u arritën këto? Aty ku këto nuk u arritën (plotësisht), çfarë shihni si pengesa? Cilët aktorë apo individë kishte për synim nisma përse i përket transferimit dhe cilat ishin rezultatet?

Situata aktuale/zbatimi

3. Cilat janë iniciativat aktuale civile për të mbështetur zbatimin e marrëveshjeve?
4. Si janë angazhuar gratë në këto përpjekje që kanë të bëjnë me dhe që punojnë me njëra-tjetrën? A ekziston ndonjë koalicion, rrjet apo platformë që ka kërkuar të kombinojë përpjekjet dhe ndikimin? Nëse po, cilat janë disa nga mësimet e nxjerra nga këto përpjekje dhe çfarë mundësi shihni për të përparuar? Nëse jo, a ka njohuri të veçanta në lidhje me "mënyrën se si" gratë paqëndrueset kanë ndërvepruar (ose jo) me njëra-tjetrën dhe a lidhet kjo gjë me llojet e rezultateve të përfshirjes që shihen deri më sot?
5. Deri në çfarë mase janë gratë aktualisht të përfshira në procesin e zbatimit? Çfarë rolesh specifike luajnë gratë në këto aktivitete (p.sh. udhëheqje, hulumtime, avokime)?
6. Cilat janë pengesat kryesore për pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes në Kosovë?

Vazhdim

7. Si do ta planifikoni zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit – kë do të përfshini dhe si? A do të ishte ndryshe nga aneksi i zbatimit?
8. Si do të dëshironit të monitoroni dhe kontrolloni progresin – cilët tregues do të demonstroi progres? Si do të trajtonit çdo shkelje të marrëveshjes?
9. Në klimën aktuale politike dhe paqëndrueset në Kosovë, e cila duket se paraqet një numër sfidash, si i shihni pikat hyrëse për t'i bërë proceset në vazhdim më gjithëpërfshirëse (përqendrimi në procese rajonale dhe vendore)? Cili, sipas mendimit tuaj, duhet të jetë roli i iniciativave të Modelit II (*Track II*)?
10. Si mundet komuniteti ndërkombëtar të mbështesë në mënyrë më efektive përmbushjen e këtyre pikave hyrëse? Cilat burime, mekanizma apo mbështetje shtesë do të nevojiteshin për të arritur pjesëmarrje më të madhe?

Pyetje shtesë:

1. Dëshironi të shtoni diçka, apo ka ndonjë gjë që nuk ju kam pyetur dhe që duhet të ju kem pyetur?
2. A jeni në dijeni të ndonjë aktori/eje tjetër (të shoqërisë civile apo tjetër) me të cilin/ën do të rekomandonit të flisnim për këtë dokument politikash/studim?

Appendix B. Bibliografia e Intervistave

Intervista 1: Prishtinë, 30.01.2024

Intervista 2: Prishtinë, 02.02.2024

Intervista 3: Prishtinë, 06.02.2024

Intervista 4: Prishtinë, 08.02.2024

Intervista 5: Prishtinë, 09.02.2024

Intervista 6: Prishtinë, 09.02.2024

Intervista 7: Prishtinë, 12.02.2024

Intervista 8: Prishtinë, 12.02.2024

Intervista 9: Prishtinë, 13.02.2024

Intervista 10: Prishtinë, 13.02.2024

Intervista 11: Prishtinë, 13.02.2024

Intervista 12: Prishtinë, 13.02.2024

Intervista 13: Prishtinë, 14.02.2024

Intervista 14: Prishtinë, 14.02.2024

Intervista 15: Prishtinë, 14.02.2024

Intervista 16: Prishtinë, 15.02.2024

Intervista 17: Prishtinë, 15.02.2024

Intervista 18: Prishtinë, 16.02.2024

Intervista 19: Prishtinë, 16.02.2024

Intervista 20: Prishtinë, 16.02.2024

Intervista 21: Prishtinë, 16.02.2024

Intervista 22: Prishtinë, 16.02.2024

Intervista 23: Prishtinë, 16.02.2024

Intervista 24: Prishtinë, 16.02.2024

Intervista 25: Prishtinë, 16.02.2024

Intervista 26: Prishtinë, 19.02.2024

Intervista 27: Prishtinë, 19.02.2024

Intervista 28: Prishtinë, 19.02.2024

Intervista 29: Prishtinë, 19.02.2024

Intervista 30: Prishtinë, 20.02.2024

Intervista 31: Prishtinë, 20.02.2024

Intervista 32: Prishtinë, 20.02.2024

Intervista 33: Prishtinë, 20.02.2024

Intervista 34: Prishtinë, 21.02.2024

Intervista 35: Prishtinë, 22.02.2024

Intervista 36: Prishtinë, 23.02.2024

Intervista 37: Prishtinë, 23.02.2024

Intervista 38: Prishtinë, 23.02.2024

Intervista 39: Prishtinë, 23.02.2024

Intervista 40: Prishtinë, 26.02.2024

Intervista 41: Prishtinë, 29.02.2024

Intervista 42: Prishtinë, 29.02.2024

Intervista 43: Prishtinë, 07.03.2024

Shtojca C. Shpërndarja e segmenteve të koduara nga të dhënat në lidhje me momentet kryesore në proceset e paqes.

Pikë Kritike



